

INTERVISTË ME IBUSH JONUZIN

Vushtrri | Data: 28 korrik, 2021

Kohëzgjatja: 139 minuta

Të pranishëm:

1. Ibush Jonuzi (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Korab Krasniqi (Intervistuesi)
4. Besarta Breznica (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zotëri Ibush, nëse mundeni me na u prezantu, me datë të lindjes, vendin, diçka me na tregu për familjen e ju, prejardhjen?

Ibush Jonuzi: Përshëndetje, mirë se keni ardhë, jam i nderuar që sot jeni në shtëpinë time. Sepse po e them fillimisht një thënjë të presidentit Rugova, “Ne nuk duhet të mbyllemi në vetëvete duhet të tregojmë kush jem dhe çka jem”. Andaj, pra jam Ibush Jonuzi, pra kom lindë me 28 janar, të vitit 1950 në fshatin Sumë atëherë, e tani është thirrë Pasomë, po fshati realisht duhet të quhet Sumë. Bile ish administratori amerikan në Vushtrri që ka qenë Charles Denison Lanen pat thonë në një moment, “Pse” tha, “po ja ndërroni emrat fshatrave?” Thashë, “Jo, Deni, nuk po ja ndërrojmë, po Sërbija i ka ndërrue se përndrysh origjinaliteti i fshatit osht’ Suma”.

Rrjedh prej një familje mesatare, baba im është marrë me bujqësi dhe blegtori, nona gjithashtu amvise. Por kanë qenë shumë ambicioz në punë dhe në aktivitete që i kanë bo. Përndrysh, po e tham kështu me sinqeritet baba im kur ka dalë në fushë me punue u konë model i krejt fshatit, “U dalë Sefedini, s’ka ça pritët duhet me dalë me punue”. Gjithashtu edhe nona ka qenë ni amvise shumë e vyshme, shumë. Edhe pse baba më ka vdekë qe 52 vite, nona qe 19 vite, po në vazhdimësi përmenden në meset familjare se kanë qenë dy prindë shumë të vyshëm.

Prej atij, prej atyne dy prindëve, prej Sefedinit dhe Sylemës kom bo ni analizë të trungut familjar. Ne sot jem 179 anëtarë të familjes, prej atyne 102 femra dhe 77 mashkuj. Shkollën fillore katër-vjeçare e kom kry në fshat, pra në fshatin Sumë. Ka qenë me tri klasë, shumë, shumë e dobët, ndërtimi i saj. Por në atë kohë ka qenë ashtu. Kurse, prej klasës pestë deri në klasën e tetë e kom kry në fshatin Smrekonicë. Që do të thotë se në dy drejtime osht’ dashtë me udhëtue gjashtë, dymdhetë kilometra, që ka qenë mjaft fshtirë. Pse? Atëherë edhe stina e dimrit edhe vjeshta, kanë qenë krejt ndryshe sikur se që osht’ sot.

Pastaj ka qenë ni karakteristikë e veçantë se atëherë s’ka pasë rrugë, osht’ dashtë në kushte shumë të rana me udhëtue, domethonë dymdhetë kilometra. Po edhe pse kom udhëtu dymdhetë kilometra po më vjen keq me thonë, po jom konë nxonësi ma i mirë në klasë. Pastaj kam vazhdu shkollën e mesme

teknike në Mitrovicë, e ashtuquajtura ka qenë shkolla e mesme teknike “Boris Kidriq”. Që në ish-Jugosllavi ka qenë shkolla ma e mira shkolla e Mitrovicës. E kom krye shkollën e mesme teknike, e kom kry shkollën e lartë teknike dhe me 16 shkurt të vitit 1973 jom punësu në minierën me flotacion “Trepça” në Stantërg, ku edhe kom qenë bursist i “Trepçës”.

Anita Susuri: Deshta me ju pyt për këtë shkollën, a ka qenë në veri të Mitrovicës apo...?

Ibush Jonuzi: Po, shkolla e mesme teknike ka qenë në veri të Mitrovicës edhe në atë kohë une kom udhëtue 32 kilometra në dy drejtimet. Prej Pasome në Mitrovicë ka qenë 16 pikë diçka kilometra veç po thom 32 kilometra që ka qenë shumë vështirë, shumë ranë.

[Këtu ndërpritet intervista]

Anita Susuri: Qysh ka qenë udhëtimi deri në shkollë, thatë që ka pasë shumë rrallë transport?

Ibush Jonuzi: Ka pasë vetëm një autobus, bile mini-bus ka qenë në atë kohë që ka udhëtue Vushtrri-Mitrovicë. Ne u dashke me dalë në Smrekonicë, po 50 për qind ose 60 për qind të rasteve nuk kish mundësi me hyp fare, sepse mini-busi i vogël edhe udhëtarë qashtu, nxanësa. Po ju tregoj një rast, erdh autobusi, s’mujtëm me hyp edhe ata kolegët thanë, “Valla s’ka vend Ibush”. Kom vrapu prej Smrekonice deri në shkollë teknikës. Kur jom shkue profesori i matematikës tha, “Çka u bo kështu Ibush?” Thashë, “Qishtu profesor s’mujta”. “Po pse kështu more magar?” Tha, “Pse kështu me u bo?” Krejt u bona që thojnë sikur me më qit ujë, krejt trupi qull u bo t’u vrapue, vetëm mos me u vonu për orë. Po thomë, ka qenë rend, ka qenë disiplinë atëhere.

Anita Susuri: E qysh kanë qenë raportet, po më doket atëherë nëpër shkolla serbë ka pasë, ka pasë edhe serbë...

Ibush Jonuzi: Po, ka pasë, po.

Anita Susuri: Qysh kanë qenë raportet atëherë?

Ibush Jonuzi: Raportet kanë qenë...

Anita Susuri: A ka pasë profesora serbë a?

Ibush Jonuzi: Ka pasë shiptarë, po ka pasë edhe serbë. Disa landë na atëherë i kemi dëgju sërëbisht që ka qenë ni kriter shumë i randë. Thashë edhe në fillim ka qenë kriteri shumë i rondë, po ja nisën me ardhë kuadra shqiptarë edhe ditë për ditë gjendja ndërrojke për të mirë. Përndrysh, ka qenë edhe një herë po e potencoj shkollë e mesme teknike me kriterë shumë të forta. Kjo ka qenë çashtja e shkollimit.

E kryva shkollën e mesme edhe po ju thom të drejtën mendojsha me hy si teknik se ke pasë mundësi ku dush me u punësue. Edhe ni bashkëvendas i imi thotë, “Ça po bon Ibush?” Thomë, “Qishtu po du

me hy në punë”, “Ku?” Thashë, “Në Obiliq”. Tha, “Gjynah osht ti me hi në punë mos me kry fakultetin”. Po ish ni problem tjetër se më vdiq baba edhe meta hala pa e kry shkollën e mesme. Nona si none, e përjetova rondë vdekjen e babës, shumë ronë.

Anita Susuri: A je konë ti vëllau i madh i familjes?

Ibush Jonuzi: Jo, ma i vogli une jom konë.

Anita Susuri: A ma i vogli.

Ibush Jonuzi: Ma i vogli. Tre vëllezër, une kom qenë ma i vogli. Po ata nuk kanë qenë në shkollë, domethonë kam qenë fëmijë i parë i familjes gjonë që jom shkue në shkollë të mesme në atë kohë. Edhe ka qenë fshtirë, sepse sot mundësia e konsultimit ki sa të dush kuadra në familje. Une kam në familjen time një doktor shkence, dy magjistra, pse magjistra se ata e kanë kry pesë vjet fakultetin, dy vjet magjistraturën. I kom dy mastera, i kom tre me fakultet, i kom katër nipa e mesa që jonë në fakultet do të thotë ki mundësi me konë dush m’u konsultu.

Po edhe interneti tash po e bon të veten, atëherë s’ke pasë mundësi, ni problem ma të vogël u dashtë, qysh thojnë me fjalë popullore m’u zi e m’u zi, qysh me zgjedh ni problem, ni detyrë a diçka. Edhe sikur më tingëlloj në vesh ajo thanja e atij bashkëvendasit tim, e lashë pasi i pata pregaditë dokumentat, jom shku në shkollë të lartë teknike, jom regjistruar. E kom kry në afat, domethonë në ‘70-tën kam filluar, në ‘73-tën jom punësuar në Stantërg, siç thashë kam qenë edhe bursist i “Trepçës”. Po nuk kom nejt me ato se e kom pa që osht’ mëkat me metë. Edhe meniherë e kom regjistru fakultetin, e kom kry fakultetin.

Anita Susuri: E fakultetin me bursë e keni regjistruar, a shkollën e mesme?

Ibush Jonuzi: Ja-a, shkollën e lartë e kom kry une me bursë. Teknikën me burse, kurse fakultetin e kom kry kështu me...

Anita Susuri: Atëherë qysh ka qenë, nëse një ndërmarrje ta ka jep bursën ti ke qenë pastaj i obliguar me punu aty, a qysh?

Ibush Jonuzi: Po, ka qenë, qashtu ka qenë kontrata që ajo ndërmarrje që ta jep bursën, atëherë pas kryerjes së shkollës me u punësuar në te. E për mu ka qenë privilegj i madh m’u punësuar në atë kohë në “Trepçe”. Me 16 shkurt të vitit ‘73, kom filluar me punuar në “Trepçe”. Përndrysh, në atë organizatën bazë që jom punësuar kom qenë inxhinjeri i parë, as teknik shiptarë s’ka pasë. Kur kom hy në zyrë unë, aty ka qenë një malazet drejtor, a sërbi a, thojke, “Jom malazet” po sërbi ka qenë. Edhe ja qita atë fletëpranimin {sikur jep fletën}, tha, “Ulu qatje çun” po më thotë veç sërbi, kuptohet.

Kqyra ku m’u ulë, s’patë karrikë. Edhe meta në komë, për fat udhëtova prej Pasome edhe shi ra në atë mëngjes na boni qull, atëherë as çadra s’ka pasë, duhet me pranuar realitetin. Edhe e murr atë fletëpranim tha, “Ulu qatje”, meta në komë. U lodha gjithë ditën, doemthonë prej orës 07:00 deri ka në

14:15, u konë ni varëse e teshave që thojnë e ka pasë njëfarë *police* [srb.: raft] edhe jom shku qaty jom ulë. Të nesërmen ma pruni ni karrikë, u ula. Aty ka qenë vetëm ni shiptarë i kualifikum, do të thotë qai e ka gjet veten në qat mes, përndrysh krejt jonë konë sërë. Shumë shiptarë të minierës me flotacion “Trepça” u befasoishin qysh une shkova aty. Thashë, “Nuk e di, qitu më kanë dërgue” edhe nime s’kisha lidhje une me shku aty.

Po ju tregoj ni rast tani historia ça qet, unë kohë pas kohe ecsha, ecsha me pune, ecsha me rezultate, po ju thom të drejtën une dy herë i kom marrë medaljet në “Trepçe” për medalje të punës, medalje të arta kom marrë dy herë. Ju bona drejtor qati drejtorit të parë timit. Edhe po më thotë niherë, “E more Ibush kush e ka mendue” tha, “që ti bohesh drejtor i jem”. Thashë, “Po se ti ditën e parë të punësimit më ke lonë në komë, nuk më ke pru karrikë hiç”. Edhe u skuq tha, “Jo”. Thashë, “Jo, është e vërtetë” para masës i thojsha, “osht’ e vërtetë. Ditën e parë” thashë, “unë s’e harroj deri të vdes. Në vend se mu gëzue” thashë, “une meta në komë pa pasë mundësi me u ulë në karrikë”. Thashë, “Po s’ka problem”. Domethonë qishtu ka qenë fillimi aty. “Trepça” ka qenë gjithçka.

Po ju tregoj edhe ni detal tash për “Trepçën”, në vitin, në vitin 2007 ne shkumë një konferencë ballkanike në Turqi. Ishim katër deputetë të parlamentit të Kosovës. Ai burri që e eliminun, ky farë [Oliver] Ivanoviqi, Teuta Sahatçija, une Ibush Jonuzi edhe Hydajet Hyseni. Masi u krye konferenca na çunë në darkë. Edhe tash [Hydajet Hyseni](#) p’i thotë atij ligjëruesit, profesorit të respektuar, tha, “Profesor” tha, “Ibushi osht’ inxhinjer i ‘Trepçës’”. “Ha, inxhinjer!” {ngrit pak trupin} qishtu besoni u lëkund prej karrike, tha, “Si është ‘Trepça’?”. Thashë, “Profesor ashtu-ashtu” thashë, “kur të vini ju në ‘Trepçe’ ko me ju dhonë n’i kristal të ‘Trepçës’ me majt për kujtim”. Tha, “Ambasadorit tonë kur vjen ja jep”.

Përndrysh, tha, “Shiqoni ‘Trepçën’ e keni vetëm ju dhe askush tjetër s’ka ‘Trepçe’”. Tha, “Une jom gjenerata e 14 e llordëve, në vazhdimësi” tha, “e kena përcjellë. Une ligjeroj qe 50 vite” tha. P’e përsërit tha, “‘Trepçe’ keni vetëm ju dhe askush tjetër ‘Trepçe’ s’ka”. Do të thotë, po thom me këtë se “Trepça” ka qenë gjithçka ka qenë. Po fatkeqësisht sot gjithçka ka ndrrue, në vend se me ndrru për të mirë shumë gjana kanë stagnue veç dhashtë Zoti vijnë ditë më të mira për të gjithë.

[Këtu ndërpritet intervista]

Ibush Jonuzi: Po ju tregoj ni detal në shkollën e lartë teknike kur jemi regjistru, jemi regjistru 72 studentë në degën e xehëtarisë. Kur e fitum kushtin për vit të dytë, kemi qenë vetëm gjashtë që e kena fitu kushtin. Edhe aty osht’ pak rast karakteristik, prej atyne gjashtëve, pesë kemi qenë të martuem. Edhe ni ditë si të ri në, ishim ni kabinet t’u bisedue erdh profesori, ni profesor shumë i merituem ka qenë, shumë i respektuem. “Çka o kjo? Çka o kjo?” Ni kolegë p’i thotë, tha, “Vallahin profesor kem tu bisedu” “Çka ket tu bisedue?” Tha, “Na” tha, “edhe me fakultet” tha, “edhe me nuse”. “Çka o kjo punë?” “Po qe na pesë të martuem, krejt e kena fitu kushtin, veç qeky...” {tregon me dorë para vetes} edhe ai ka pasë ardhë prej Prishtine, prej fakultetit të Maqedonisë në Prishtinë.

Edhe po më drejtohet profesori, “A osht’ e vërtetë Ibush?” Thashë, “Po, profesor”. “Te pestët jeni të martum?” Thashë, “Po, të pestët jemi të martum” (buzëqeshë). Po ndërrojnë raportet, e thashë ma

herët shkolla teknike ka qenë shumë fshtirë. Pse? Shumë landë u dashtë me i dëgjue sërbisht, literaturë s'ka pasë, ka pasë literaturë veç sërbisht, asni tekst ti në atë kohë s'ke mujt me pasë në shqip. Kurse edhe edhe në fakultet se për herë të parë fakulteti xehëtaro-metalurgjik osht hapë në Mirovicë në vitin '70, '70 osht hapë, e pastaj ka fillue. Po në atë kohë me kry fakultetin ti ke pasë perspektivë ku dush me u punësue. Sot fatkeqësisht edhe p'e kryen edhe s'ka. Se të gjitha kuadrat që e kanë kry në atë kohë janë punësu në "Trepçe".

Dul gjenerata e parë e gjeologëve të fakultetit të Mitrovicës edhe bomë kërkesë me i punësue në "Trepçe", unë atëherë kam qenë drejtor teknik në "Trepçe" edhe po ju thom sinqerisht, na nuk kishim nevojë për shtatë gjeologë. Kishim një, dy {numëron në gishta} se kishim gjeologë. Po për hirë që ish gjenerata e parë shiptare, për hir që unë e pyeta ni profesor shumë të respektushëm thashë, "Qysh janë këta studenta?" Tha, "Ibush, janë shumë të mirë" tha, "edhe profesorët e Beogradit që ligjërojnë këtu te na thojnë që ma të mirë janë këta studenta se studentat e Beogradit". Edhe i pranum të gjithë në punë. Me të vërtetë kanë qenë të mirë edhe erdh mundësia edhe me i punësu edhe me ju ndihmu edhe krejt.

Anita Susuri: Deshta me ju pyet për "Trepçën" që ka qenë shumë e famshme, sidomos për rrethin e Mitrovicës, për fshatra, e Vushtrrinë e... po nuk e di sa keni qenë në dijeni të një historie të "Trepçës" për anglezët që kanë filu me hulumtimet e para...

Ibush Jonuzi: Po, po.

Anita Susuri: A dini diçka prej kësaj, a mundeni me na tregu?

Ibush Jonuzi: Po, anglezët kanë hulumtue në vitet 1927 deri në vitin 1930, në vitin 1930 ka fillu prodhimi i parë në "Trepçe". Po edhe profesori i nderuar që thashë ma herët Lordi Robert ka qenë, profesori që tha, "E kena përcjellë gjeneratë pas gjenerate" ai ka qenë vet anglez, "çështjen e 'Trepçës'". Ata e kanë shfrytëzue në mënyrë shumë profesionale edhe pse kanë qenë do të thotë vitet e '30-ta, po çështja e sigurisë se miniera është shumë e rrezikshme. Po, po e thom miniera e "Trepçës" në krahasim me shumë miniera tjera osht' shumë stabile, se shkëmbinjtë përcjellës aty pjesa dërmuese janë gëlqëror edhe janë trupa të fortë.

Por, sidoqoftë, ka pasë, nuk është teknika se qysh osht' sot mundësia e shfrytëzimit e realizimit të planit prodhimit, po krejt ka qenë punë fizike, punë e vështirë, punë e rondë. Megjithatë, rezultatet janë mjaft të mira. E pas anglezëve dihet tani në kohën e luftës e kanë shfrytëzue edhe gjermanët edhe pastaj kanë hy gjeneratat tona. Inxhinjeri i parë në "Trepçe" shqiptar ka qenë, profesor doktor Minir Dushi që osht' akademik, që edhe sot osht', që është ni burrë shumë i meritum. Ai në fakultet gjithçka ka bo për ne studentat shiptarë edhe gjithë kuadrat shiptarë që janë dalë. Na jena studentat e profesor Minir Dushit edhe nëpërmes këtij emisioni e përshëndes përzemërsisht, se ka dhonë kontribut shumë të madh.

Profesor Miniri në atë kohë... se minatorët e kanë pasë gjuhë ma tepër gjuhën serbo-kroate. Nuk ka ditë me thonë, "Quhem Ibush Jonuzi" po sërbisht e ka thonë. Ose atë numrin e pagesës, u dashtë,

rregull u konë me i lonë numrat. Për shembull, unë e kom pasë numrin 116, me ditë kur hish në minierë, kur dalsh prej miniere, krejt ato. Edhe ata s'kanë ditë me thonë numri i rrogës po kanë thonë *platni broj*. Më fal që e përdora kështu sërbsisht, po në origjinalitet. E profesor Miniri vazhdimisht tu ju dhonë vërejtje, "Nuk bon ashtu, duhet shqip m'u mësue".

Anita Susuri: Termet s'i kanë ditë?

Ibush Jonuzi: Termet s'i kanë ditë, s'kanë ditë ata. S'kanë pasë shkollë, pos nëse e kanë pasë naj kurs të sërbsishtës krejt ato. E profesor Miniri përveç në atë aspektin profesional edhe në aspektin kombëtarë ka dhonë kontribut shumë të madh si inxhinjer i parë në "Trepçe".

Anita Susuri: E ju kur keni marrë vendim me e marrë këtë profesion, a e keni ditë cilat janë vështirësitë? Që osht' vështirë, keq, është punë e keqe për minatorët, mundet me pasë aksidente, me siguri i keni ditë krejt këto. Çka ka ndiku që qekjo mos me u marrë për bazë edhe me vendos për këtë profesion?

Ibush Jonuzi: Po unë e kom pasë edhe traditë familjare. Baba më ka punu një kohë në minierë, axha më ka punu në minierë, dy djem të axhës më kanë punu në minierë. Njeni prej tyne i ndjeri edhe ka vdekë në minierë, e ka zonë dheja në vitin 1948 edhe i ri 26 vjeçar është myt në minierë. Une kur e kom fillu punën në Stantërg, thashë në vitin '73, mas ni kohe meniherë kom hulumtue dokumentacionin qysh osht' myt, si është myt? Ata kanë qenë dy djem të axhallarëve bashkë, njeni është myt në vend, tjetri është lëndue, po ai ka shpëtue. Do të thotë, kom pasë traditë familjare për me u punësu në "Trepçe" edhe e kom dashtë atë profesion. Me kohë kështu e kom dashtë, se baba rrëfeje shumë herë qysh kanë udhëtu prej Pasome në Stantërg në komë edhe u dashtë bukën me marrë me veti. Këpucët e punës me i marrë me veti se s'kanë pasë atëherë kushte ku me i lonë, e domethonë kanë udhëtu në qat' kohë. Kom pasë shumë të familjes që kanë punu në "Trepçe".

Anita Susuri: E çka tjetër tregon, për shembull për punën atëherë? Ka qenë me mjete shumë ma të prapambetuna, ma fshtirë ka qenë me punu? A mundeni me përshkru tregimin e babës juj për "Trepçën"?

Ibush Jonuzi: Po e thashë, t'u fillu prej udhëtimit, prej ushqimit, prej veshëmbathjes, mjetet e punës, mjetet siguruse për punë, në atë kohë kanë mungue të gjitha, nën një. Nën dy, krejt ka qenë punë fizike. I kanë pasë do çekana shpues edhe tjetër çdo gja u dashtë fizikisht me e krye punën e vet, kanë bajtë me vagoneta, me krahë xehen e kanë bajtë. E kanë ngarku me lopatë e kanë thy me çekan, të gjitha ato janë konë po thom punë shumë të mundimshme. Kurse tani situata është krejt ndryshe, edhe në kohën kur kom fillu unë ka qenë situata ma e mirë sesa në atë kohë kur ka punu baba jem e djali axhës e axha tjetër, e krejt ato.

Anita Susuri: Qysh na kanë tregu në Luftën e Dytë Botërore ka pasë edhe robë të zonun që i kanë detyru me punu.

Ibush Jonuzi: Po, ka pasë. Në bazë të shenimeve që kanë ekzistue, ka pasë edhe robë të luftës edhe të burgosun që kanë punue në minierë. Kanë punue në krejt orarin e punës edhe jonë dërgue pastaj në ato kazamatet ku i kanë pasë ata. Ka pasë robë lufte.

Anita Susuri: E këto kazamatet çka jonë, qysh? Si vende për strehim?

Ibush Jonuzi: Po, ku i kanë strehue, po.

Korab Krasniqi: A na kallxoni pak për këtë pjesën e gjermanëve se për anglezët kallxut. Prej 1927-1930 është bo ni hulumtim, prodhimi i parë...

Ibush Jonuzi: Prodhimi, prodhimi...

Korab Krasniqi: E gjermanët kur janë ardhë edhe çka osht' punu deri sa janë konë gjermanët? A ka pasë naj transformim, për shembull teknologjik, industrial të prodhimit e kështu me radhë deri sa janë konë ata? Po flasim prej asajna çka ke dëgju edhe çka ke lexu.

Ibush Jonuzi: Po ka pasë ndryshime, suksesivisht në "Trepçe" janë bo hapa, po hapa të vogël, në vazhdimësi ka pasë ndryshime pozitive për m'u përmirësue jeta e minatorit, kushtet e minatorit, siguria, krejt ato. Ka pasë ndryshime pozitive.

Anita Susuri: Thatë për robërit e këta krejt tjerët që kanë punu domethonë me dhunë. Sa ka mujt me qenë e fshtirë puna kur kanë pru aty robër me punu? Ka pasë njerëz që kanë punu për rrogë për shembull, a ka qenë ky i vetmi dallim domethonë rroga, paga apo edhe kushtet tjera në të cilat kanë punu për shembull? Këta që janë pagu a kanë qenë në pozita ma të mira të punës sesa robërit, a e dini këto?

Ibush Jonuzi: Nuk... me siguri kanë qenë në pozita pak ma të mira këta punëtorët e rregullt, që jonë konë domethonë me paga mujore, në krahasim me ata që kanë qenë të ndëshkuar do të thotë, aty i kanë pru si ndëshkim për me i shfrytëzue. Ndryshimi ka qenë, normalisht ka qenë edhe ata që kanë udhëheqë jonë konë krejt të punësuar. Parapunëtorë, mbikëqyrës, punëtorë, menaxher, krejt ato jonë konë kuadra që kanë qenë në paga mujore. Kurse ata vetëm i kanë shfrytëzu kështu në mënyrën ma të vrazhdë në atë kohë.

Përndrysh, në "Trepçe" une kom has në punime të vjetra ku xehja osht' bart me kolicë të drunit, kolicën e dimë çka osht'. Ka qenë ni punim që na në atë kohë kena punue prej kuotës 610 në kuotën 915, naltësia mbidetare m'u lidhë me minierë. Kur kena depërtu ni pjesë une kom hi kështu kom qenë shumë kurreshtar me pa çdo, që thojnë çdo detal me pa ku osht' çka osht'. Aty pata hasë në një kolicë të dorës krejt ka qenë e drunit, jo sikur kolica të tashme të metalta e me rrotë të gomës e krejt, po krejt ka qenë dru.

Edhe osht' shfrytëzue në mënyrë ma të rondë, do të thotë me dalta, me çekana të vogël, qashtu u shfrytëzu xehja, jo sikur sot me 500-600, 5.000-7.000 metër katror sipërfaqja qysh shfrytëzohet. Une

kom qenë në vitin '87 në miniera të Gjermanisë në Velenje, edhe kur e kom pa minierën fantastike, po kur e kom pa trupin e xehes që osht' në Gjermani në minierë me tonën osht' krahasimi, i pakrahasueshëm po thom. Këtu çfarë trupash ka pasë edhe ka, e çfarë trupash kom pa unë veç damarorë në Gjermani.

Anita Susuri: E qysh o për shembull dallimi, për dikun që s'e din?

Ibush Jonuzi: Dallimi osht' se këtu thashë që ka 5.000-6.000 mijë metra katrorë sipërfaqja ku shfrytëzohet xehja, aty ka qenë damari nashta 20 centimetra, qat' damarë, xehe damarore e kanë shfrytëzu ata gjermanët. Amo, kushtet në Gjermani s'mujsh me i krahasu me kushte tona. Që edhe ata më kanë ofru atëherë '87-tën m'u nalë me punue në Gjermani edhe pse jom shku, zyrtarisht jom shku prej "Trepçës". Edhe t'u bisedue, ni drejtor ish konë hungarez aty, përndrysh hungarezë të Vojvodinës.

Edhe po më thotë tha, "Ibush" tha, "a po nalesh me punue në Gjermani këtu në minierë?" Thashë, "Çka më ofroni?" Tha, "Të ofrojna shtatë mijë marka rroga në start, ta dhomë kerrin zyrtar zero-zero. Sa të dush kredi të dhojna. Varësisht prej prodhimit që ti e bon planin e realizimit e ki përqindjen tonde". Tha, "Qeto janë kushtet që na ti ofrojmë që ti mu nalë në 'Tre...' në Gjermani". Thashë, "Jo, falemnderit shumë!" "Pse?" Thashë, "Jo, nuk muj. Kom obligim për 'Trepçën' kurrë nuk nalna".

Do të thotë, ka qenë ni detal që në atë kohë edhe ata e kanë ditë. Pse, se na e kena pasë ni bashkëpunim shumë të ngushtë me gjermanët, ata vazhdimisht kanë ardhë në minierë, kanë pru mjete, kanë pru mekanizim të ndryshëm. Do të thotë jena njoft. Edhe po m'vjen keq me thonë, prej punës që e kom bo, prej rezultateve ata më kanë njoft mirë si kuadër që kam qenë une në "Trepçe".

Anita Susuri: A e dini si kanë qenë në ato vitet e '40-ta pagat për shembull? Kur ka punu baba juj e mixhallarët?

Ibush Jonuzi: Jo për ner, nuk muj me ditë, se osht' kohë e gjatë e...

Anita Susuri: Qysh jonë pagu a?

Ibush Jonuzi: Nuk e di, nuk muj me ditë, se masi s'e di nuk muj me folë ashtu. Që thojmë na veç me folë kuturu nuk muj.

Anita Susuri: Po. Në kohën kur keni ardhë në "Trepçe" në vitin '73...

Ibush Jonuzi: Po.

Anita Susuri: Ka qenë ni periudhë ma e mirë për pozitën e shiptarëve se edhe '74-tën u bo kushtetuta...

Ibush Jonuzi: Po, po qashtu.

Anita Susuri: Qysh e keni pa ju “Trepçën” atëherë? Në çfarë gjendje u konë “Trepça”?

Ibush Jonuzi: “Trepça”, apet p’e thomë atë thonjën: Trepça osht’ Trepçë. Aty me punue ka qenë krenari. Pse? Në ish-Jugosllavi inxhinjeri që ka punue në “Trepçë” çdokund i ke pasë dyert e hapura me punue pa konkurue, veç kërkesë, “Po du me u punësue në qet minierë” ti je shkue. Shumë kuadra, shumë, jo shqiptarë kuptohet veç të nacionaliteteve muslimanë, sërbë, malazezë i kanë zgjedh vendat ku kanë dashtë në ish-Jugosllavi ku kanë qenë kuadra të “Trepçës”. Sepse “Trepça” ka qenë shkollë, jo vetëm minierë, po shkollë ka qenë.

Bashkëpunimi ndërmjet minatorëve ka qenë jashtëzakonisht i mirë, respekti ka qenë shumë i madh. Po më vjen keq me thonë se osht’ marre për mu, veç une kur jom kthy 2014-tën në “Trepçë”, unë e kom pa qysh punohet tash e qysh osht’ punu atëherë. Ka qenë respekti udhëheqës-minator shumë i madh. Minatori nuk të ka prit ulun, të ka prit në komë kur të ka pa, e ka ditë në gjithçka udhëheqësin e vet. E po thom, ato raporte kanë qenë shumë madhështore, ka qenë tjetër ni veti e veçantë që aty janë kalit njerëzit. Ti s’ke ndëgju në minierë me pasë mes veti problem minatorët, ja me udhëheqje, ja...

Do të thotë, edhe pastaj u dëshmue në marshin e nëntorit, në grevën e minatorëve të gjitha ato që janë thonë o dëshmue. Sepse ju e dini keni ndëgju edhe pse jeni të ri, se shtylla, goditja kryesore e shpërbërjes të ish-Jugosllavisë ka qenë marshi i minatorëve edhe greva e minatorëve. Deshti s’deshti dikush me pranue, ky është realiteti. Sot me dalë në protesta, sot me kundërshtue edhe qeverinë edhe presidentin edhe çdokënd, çdokush po e bon, amo në atë kohë me ja qit gjyksin okupatorit, se okupator po i thom kështu me plot kuptimin e fjalës, nuk ka qenë bash, bash lehtë. U dashtë ni gatishmëri, ni sakrificë shumë e madhe për me i bo ato akte, e minatorët i kanë bo, po bashkarisht i kemi bo të gjithë.

Ni detal du me ju tregue, kur jena nisë për Prishtinë në marshin e minatorëve, një delegacion suedez ka pasë me ardhë në minierë për me bo kontrata me pru paisje për minierë. Në rrugë u nalën me makinë bisedova me ta, “Çka osht’...” po më thonë, “drejtor”, thom, “Kështu, kështu, kështu”. “A janë këta inxhinjerat këtu?” Thashë, “Po”, “Vazhdoni” tha. Edhe jonë kthy ata përmrapa, do të thotë kanë qenë raportet shumë ngushtë të lidhuna {bashkon duart} edhe besimi ka qenë shumë i madh mes minatorëve dhe udhëheqësve në “Trepçë”.

Anita Susuri: Para se me vazhdu te marshi i kom disa pyetje tjera, nëse mundeni me na përshkru punën e juj ose ni ditë të zakonshme pune që e keni bo ju në minierë qysh ka qenë, në “Trepçë” po meno?

Ibush Jonuzi: Po. Me padurim e kom prit, jom zgju në ora 05:00, kom ngronë mëngjes. Nona më ka pregaditë në atë kohë edhe pastaj gruja edhe kunatat, gratë e vëllezërive kur s’ka qenë nona. Kom hongër mëngjes në shpi, kom dalë, kom udhëtu deri në Smrekonicë, gjashtë kilometra, jena hyp në autobus, kom shku në “Trepçë” në ora 07:00. Edhe vazhdimisht kom qenë me përkushtim me punue, kurrë nuk e kom kqyr une orarin e punës, kur vjen orari. Po ju thom të drejtën, e thashë unë shtatë vite kurrë s’kom shku në pushim vjetor.

Ato e dijnë të gjithë... ose katër ditë kom nejt kurrë pa ardhë në shpi, dej u ardhë vëllau tha, “More hajde se nona u tranue. Ti” tha, “s’je në veti”. Jom ra në mramje në shtrat me pushue jom dalë jom shku në “Trepçë”. E kom pasë shprehi shtune - dille kur kom punue, me shumicën kom punue, kurrë nuk jom shku me kerr, as me kerr zyrtar, as me kerr temin privat. Gjithë jom shku me minatorë me autobus, ata u kënaqshin kur më pajshin në autobus me ta, kishin qaq dëshirë. Edhe u shike që njëfarë respekti po ju boj që realisht ka qenë, unë shkojsha për respekt të tyne.

E thashë ma heret, atë drejtorin që s’më ka gjetë karrik, se në atë kohë u dashtë dymdhetë mujë me punue si inxhinjer, pastaj me hy në provim, u kon provimi i praktikantit. Komisioni i veçantë profesional të vlerësojke se a je pregadit ti për me marrë vendin e punës si inxhinjer në “Trepçë” apo jo. Edhe kalun dymdhetë, kalun tremdhetë, u bonën 14 mujë. I thojsha, “Drejtor me më shti në provim duhet me mësu zanatin”. “Ani ki kohë” thojke, “ki me punu deri në pension këtu”.

Përndrysh, hulumtojsha gjithçka, gjithçka hulumtojsha në mënyrë që me qenë i përgaditun. Nashta po përpiqna mos me tepru, po muni me marrë dëshmi prej kujt doni në vitin 1075 [1975] u kërkojke një galeri me e bo për shpejt edhe ka qenë karakteristikë krejt ka qenë harkore galeria. Une i thom ni minatori që i ndjerë osht’ tash Nezir Osmani, numri i pagesës ka qenë 45/46 (buzëqeshë), osht’ me randësi me ditë qe 32 vite as ato s’i kom harrue.

Edhe e thërras thom, “Nezir qishtu, qishtu kërkohet” thashë, “ki me pasë pagesën e mirë. Ti e bon punën e mirë”. Tha, “Shef” tha, “s’ka problem”. Përfundoj muji e realizoi ma tepër se që na e kishim objektivin, ja dhashë dy përqind ma shumë se me marrë rrogën atëherë 172 për qind ajo ka qenë, ka qenë shumë e madhe. Rrogën e ka marrë ma shumë se ni drejtor në atë kohë, minatori. Edhe po thotë, po dëgjoj po thotë, “Valla, ky inxhinjeri i Pasomës çka po thojke, qashtu po dalke”.

Eh, domethonë, nuk ju kom premtu kurgjo minatorëve, po vazhdimisht kom qenë në kontakt me ta me mësu zanatin. Nuk mësohet zanati në fakultet, ato le te harron dikush me thonë, “Valla e kom kry fakultetin tash e di zanatin”. Po flas për zanat temin {vendos dorën në gjoks}, për profesion temin, të xehëtarisë. Ai zanat mësohet në minierë edhe ato e mëson nëse don me kopju prej minatorëve të vjetër.

Nëse e don zanatin ate ki me mësu vetëm në minierë edhe nuk pritojsha me shku në minierë. Se ka inxhinjera që nashta dhetë ditë, dy javë nuk shkon. Po une mos me mujt me shku në ndrrim të parë, në ndrrim dytë jom shkue. Edhe e kanë ditë edhe këto e kanë thonë, nashta pak p’e teproj veç thojshin, “Ibushi mos me shku në minierë i dhëm koka”. Se e kom dashtë, e kom dashtë minierën me shpirt e kom dashtë, kom pasë rezultate. Nuk kom qenë unë inxhinjeri ma i mirë në “Trepçë”, po kom qenë inxhinjer që me ma përkushtim kom punu në “Trepçë”.

Edhe rezultatet kur unë e kom udhëheqë minierën kanë qenë në karrierë të “Trepçës” prej 1930-tës, rezultatet ma të mëdhaja. Asni prodhim nuk ka qenë ma i madh se unë kur e kom udhëheqë minierën. Ose ni ndrrim kur kom shku une si drejtor teknik kom hy në minierë. Minatorët e dishin si shkojsha, “Çka, çka ka?” Edhe po ju thom, “Qishti, qishtu”, “Hiç s’ka problem drejtor”. 302 skipa janë dalë brenda ni ndrrimi, domethonë 1500, 1600 tonelata gati mrena ni ndrrimi janë dalë.

Ka qenë mrekullia e krejt prodhimit të “Trepçës”. Kur jon bo 300 skipa, se skipi ka qenë 5.5 tona të xehes, ai liftit të bartjes të xehes tha, “U bonë 300” thashë, “Edhe dy” thashë, “për me i qit”. Edhe e kanë shkru në libër, se aty kujdestarë kanë qenë vazhdimisht e kanë përcjellë 302 skipa mo s’ka m’i qit kërkush edhe realisht s’ka m’i qit kërkush mo.

Pjesa e Dytë

Korab Krasniqi: Kur e keni marrë këtë detyrën e re, keni udhëheqë me minatorë e me ekipe, qysh, cilat jonë konë përgjegjësitë e juja? Po mendoj, natyrisht ju keni dhonë instruksione qysh me punu, çka me punu? Çka janë caqet e punës ju, nëse munësh pak ma detajshëm me na spjegu çka jonë konë përgjegjësitë tua në qat’ detyrë?

Ibush Jonuzi: Thashë mas 14 mujve ma bonë të mundshme e dhashë provimin e praktikantit edhe e mora detyrën kryepunëtor. Kryepunëtori ka qenë përgjegjës për të tri ndrrimet, domethonë me dhonë udhëzime, me dhonë këshilla, me kontrollu punën. Po krejt mbikëqyrësat e thashë kanë qenë sërbe, krejt parapunëtorët kanë qenë sërbe. Edhe fillova une me shkru {bën sikur shkruan} librin e urdhëresës në shqip. Edhe më thirri drejtori Radojica Vuquroviq në atë kohë.

Tha, “Ibush” tha, “këta s’dinë sërbisht [shqip]” tha, “ti i jep urdhër me punue po ai s’din” tha, “s’ta kryen punën” tha, “ai s’kupton shqip qysh po ja jep ti urdhëresën”. Edhe e kom marrë e kom shkru edhe sërbisht edhe shqip te dyjat. Do të thotë, librin e urdhëresave për punë e kom shkru edhe sërbisht edhe shqip se me të vërtetë ata e kanë ditë, unë e di që e kanë ditë, amo mujke me thonë, “Une s’kuptova, çka?” Qajo ka qenë detyra jeme fillestare, pastaj kam qenë në pozitë ma të lartë udhëheqës teknik.

Udhëheqës teknik ka qenë pozita ma e lartë që e ke menaxhu pak ma shumë sesa ni kryepunëtor që thashë i ke përcjellë veç ndrrimet. Prej udhëheqësit teknik kom qenë drejtues i njësisë punuese për hulumtime dhe shpuarje të thella. Pastaj në vitin pasues kom qenë drejtues. Nuk aka qenë drejtor, por pozita ka qenë drejtues i minierës, krejt minierës, krejt prodhimin atëherë e ke pasë në menaxhim. Kom qenë i ri po ju thom, relativisht i ri se 30 vjeçar me marrë punën me udhëheqë krejt minierën e Staritërgut nuk ka qenë e lehtë.

U dashtë me dalë para minatorëve, ka pasë inxhinjera, po ju thom shumë sinqerisht thojke, “Gjithçka punoj çka të më urdhnoish veç mos më qit para minatorëve me folë”. Se ata të kqyrshin qysh thojnë fjalë popullore sikur me llupë të kqyrshin. Po e kom kry edhe atë detyrë me shumë përgjegjësi. Ka pasë ndalesa të punës në atë kohë edhe pse ndalesa e punës, kërkoshin kushte ma të mira, paga ma të mëdhaja krejt ato. Edhe u nal puna, une isha në shpi.

Anita Susuri: Cili vit ka qenë?

Ibush Jonuzi: Ka qenë, ka qenë '83-shi, '83-shi. Edhe më lajmrojnë, shkova në punë, në tubime të punëtorëve. Ka qenë atëherë Këshilli Punëdrejtues i "Trepçës", ka qenë kryetari i Këshillit punëdrejtues edhe i ka pasë zavendësat e vet. Zavendës për çështje ekonomike ka qenë Enis Presheva, një ekonomist me famë në atë kohë. Veç ai me fakultet ka qenë, veç ai në atë kohë edhe në Ljublanë ka studiue.

Edhe atij i kish dhonë Këshilli Punëdrejtues detyrë që me përcjellë tubimin e minatorëve se ata kërkojshin domethonë rritje të pagave e kjo bike në sektorin ekonomik. Erdh Enisi në të gjitha tubimet, i ndëgjoi kërkesat e minatorëve edhe ju premtoi tha, "Na kena me bo sistematizimin e vendeve të punës". Do të thotë, unë isha drejtus i minierës. Erdh në zyre te unë u kryen tubimet, "Ibush" tha, "duhet me krye". Thashë, thashë, "Po duhet me krye", "Kush e kryen?" Thashë, "Unë e kryej". "A munësh?" Thashë, "Po, e kryj. Hiç s'ka problem".

Se u dashke me kry sistematizimin me dalë para tubimit të punëtorëve, a po e aprovojnë, a jo. Edhe u kry ajo punë. Do të thotë, u bo riorganizimi i ri, u favorizun vendet e punës të minatorëve ato që tamon u dashke me i stimulue, i qitëm në tubim puntorët të gjithë e aprovun, pa vërejtje. Kom qenë, po thom ngushtë kom qenë edhe shpirtnisht i lidhun me ta une edhe e pat pa atëherë Enisi.

Prej pozitës të, prej pozitës të drejtusit të krejt minierës më propozojnë mu për drejtor teknik, ka qenë pozitë shumë e naltë. Edhe isha në zyre e çojnë kerrin prej Zveçanit, se atëherë drejtorja qendrore ka qenë në Zveçan për "Trepçën". Shkova, kryetari i Këshillit Punëdrejtues në atë kohë ka qenë Shefqet Jashari edhe hyna në zyre, "Qysh je, si je? Qysh po të shkon puna?" Thashë, "Mirë, mirë shumë".

Tha, "Ti duhet me shku drejtor teknik edhe drejtor" tha, "Ka me qenë Rexha Dervisheviqi" ni inxhinjer i vjetër, musliman ka qenë, boshnjak që ka qenë edhe ma herët në "Trepçë" po me kthy edhe niherë ato në "Trepçë". Thotë, "Rexha ka me qenë drejtor" thotë edhe, "ti ki me qenë drejtor teknik". Thashë, "Kryetar" thashë, "faleminderit shumë", thashë, "mirë jom une" thashë, "puna po më ecë mirë, jom drejtus i minierës" thashë, "ki kuadra ma të vjetra. Ki më përvojë" krejt po ja thom ato që i menojsa.

Tha, "Krejt i dina na. Dikush" tha, "e ka analizu atë punë, ti duhet me shku aty". Besoni kërkesa ish konë e shkrume, veç me nënshkrue. Thashë, "Nuk muj me shkue" tha, "Dil pak mendo". Edhe dola ni parazyre, atëherë ajo sekretaresha që ka qenë po më thotë, "Qishtu, qishtu" tha, "kjo osht' punë e kryme se osht' bisedue" tha, "osht' bisedue në nivelin ma të lartë që ti ki me shkue".

[Këtu ndërpritet intervista]

Ibush Jonuzi: Mendova, vjen aty ni inxhinjer tjetër, "Çka ke dalë Ibush?" I thom, "Qishtu, qishtu, qishtu". Tha, "Jo, po ti s'ki arsy me refuzu" tha, tha, "dikush e ka vlerësue" tha, "ti je i vyem, ti je i sinqertë, ti je profesionist i pregaditun mirë" tha, "edhe fort mirë që e kanë bo këtë veprim". Edhe dikush të bind me dy fjalë.

Edhe e marrë e nënshkruj unë, ja çoj kryetarit, aty asistentja edhe dul tha, "Falemnderit, Ibush!" I tha vozitësit, "Ktheje në 'Trepçë'". Atëherë organi ma i madh ka qenë Këshilli, Këshilli i Puntorëve. Edhe të

nesërmen menjëherë u thirr Këshilli i Punëtorëve. Kryetari i Këshillit të Punëtorëve ka qenë një burrë shumë i mirë, shumë i nderum ni Osman Rama, i ndjerë tash osht’.

U krye seanca e Këshillit të Punëtorëve, ma urun që u zgjedha drejtor teknik edhe po më thotë, “Urime drejtor!” Thashë, “Falemnderit!” Tha, “A po mërzitësh?” Thashë, “Shumë po mërzitna” tha, “Ti ki me dalë faqebardhë” tha, “prej këtuhit” tha, “ti je i vyem, ti je i papritushëm, ty” tha, “të dojnë minatorët. Ty të respektojnë minatorët. Ti je i ri edhe ti ki me dalë faqebardhë”. Edhe besoni sikur ta heq ni barrë prej shpine, se ai ish njeri shumë i respektuem edhe më njofke mirë kështu.

Edhe pastaj fillova si drejtor teknik, që e mora edhe ma me përkushtim atë punë. Pse? Aty ishin 3470 punëtorë, ish punë me përgjegjësi edhe çashtja e sigurisë po edhe siguri i planit të prodhimit. Rexha Dervisheviqi i ndjerë, ai ka qenë... në profesion i mirë ka qenë po e ka pasë ni të metë shumë të madhe, që ka pi vazhdimisht alkohol, vazhdimisht.

Ai në zyre e majke në fiokë {bën sikur ngrehë dollapin}. Edhe kështu decidivisht e thojke, “Unë e kom lehtë” thojke, “une pi raki, lbushi punon”, që realisht edhe qishte ka qenë. Po, ai kurgjo, kur kom marrë naj vendim ai kurrë s’ka thonë jo, asniherë. As s’u përzike për çashtje të prodhimit ato krejt, shumë rrallë vike në tubime të punëtorëve, se aty u dashtë gjithqysh m’u konë nëpër tubime. Po thojke, “Masi osht’ lbushi, une s’kom ça me ardhë”. Edhe erdhëm gati te viti ‘89.

Anita Susuri: Veç paraprakisht deshta edhe diçka, më tregut për një vizitë që e keni pasë në Velenje, a ka pasë shpesh vizita që keni shku ju apo ka ardhë dikush? Qysh kanë qenë këto organizime?

Ibush Jonuzi: Në “Trepçë” kanë ardhë shumë delegacione, shumë delegacione do të thotë të minierave të Evropës kanë ardhë, e të botës kanë ardhë. Pse? “Trepça” edhe njëherë po thom në zo ka qenë, kurse ne nuk kemi dalë shumë, nuk kemi dalë. Une me të thonë të drejtën kom qenë në Gjermani atëherë, kom qenë në Rumani, rumunët patën bo ni kërkesë me shkue se fillun prodhimin e disa pajisjeve xehëtare, po vizën veç “Trepça” mujke me ja dhonë.

Nëse “Trepça” thotë se ato pajisje bojnë për minierë ajo ecke. Nëse thotë jo, ajo veç mujke me stagnue në vend. A për me qenë, me ardhë vizita në “Trepçe” ka pasë shumë. Po ka qenë kriter shumë i ashpër. Pse? U dashtë me ditë kush osht’, ça osht’, kah osht’, prej nga vjen. Regjistrin, ka qenë libri i veçantë që osht’ dashtë me regjistue edhe u dashtë leje të veçantë për me hy në minierë se s’ka mujtë. Ose ka qenë e pamundshme atëherë me bo fotografi te miniera nuk osht’ lejue, rregull ka qenë qashtu. Pa përcjellje nuk ka guxu kërkush me shku në minierë. U dashtë njeri i Stantërgut që u konë i thirrur për me udhëheqë delegacionin ja personat, ja krejt ato.

Anita Susuri: Shumica e miantorëve na kanë thonë që në kohën kur ka qenë Aziz Abrashi, Burhan Kavaja e ju, ka qenë periudha e artë e “Trepçës”, që ka pasë ma së shumti prodhim. Po nga ana tjetër kanë ekzistue edhe ato parollat që “Trepça punon, Beogradi ndërton”. Qysh ka qenë krejt kjo edhe a ka qenë edhe kjo një lloj shkak që me fillu pakënaqësitë?

Ibush Jonuzi: Aziz Abrashi ka qenë ni personalitet shumë i meritum. Ai ka ardhë kryetar i Këshillit Punëdrejtues të “Trepçës”, e thashë unë në atë kohë kam qenë drejtor teknik edhe kur ka ardhë Azizi në Këshillin e Punëtorëve, do të thotë tubimin e parë une kom raportu për prodhim. Kur e kena përfundu, kena qenë në një sallë për flotacion të minierës. Përfundoi takimi, hymë në zyre te drejtori i flotacionit, tha, “Ibush me të pyt diçka” thashë, “Urdhno kryetar”.

Tha, “A përmensh i ke mësu a?” Edhe besoni s’e kuptova, thashë, “Jo, pse?” Tha, “E kom përcjellë me presje, gjithçka e ke thonë përmensh”, thashë, “Ja-a kur dush unë t’i thom”. Edhe këto po e thom prapë sinqerisht se minatorët e kanë ditë, unë ja kom ditë çdo minatori numrin e pagës, emrin, mbiemrin nga osht’. Edhe kurrë s’ka pasë nevojë minatori me u prezantu në telefon te une se, “Jam filani” e kom njoft në zo.

Edhe i thanë Azizit, kryetarit atëherë, “Jo” tha, “Ibushi qishtu gjithë. Ky krejt këto i thotë...” se po thom qato ça e dush edhe e mëson. Edhe ato shifra u dashtë me i përcjellë në vazhdimësi, çdo ditë me i përcjellë ti {prek kokën} me logjikë u dashtë me punue. Pastaj ka ardhë Burhani drejtor e ai Rexha që thashë shkoi apat nënkryetar i Këshillit Punëdrejtues.

Ka qenë kohë e mirë. Pse? U bo kthesë e madhe, u bo restorani i punëtorëve fantazi. Kur kanë ardhë minatorët e minierës së Borit, Borin e dini, ata jane befasue. Tha, “Qesi ushqimi edhe qeso kushtesh” tha, “na nuk kena pa kërkun”. Minatori atëherë i ka pasë triskat për ushqim të ngrohtë, ushqim të thatë edhe qumësht. S’ka pasë minatorë që ka mujt krejt qat sasi me konzumu vet. E pamundshme u konë. Për çfarë gjellë e ka pasë oreksin ai ka mujt me zgjedh aty.

Ka dashtë me marrë ushqim të thatë, ka pasë suxhuk, ka pasë përshutë, ka pasë konzerva, peshq, ve të zime. Po thom, mos me citu, gjithçka ka pasë aty. Edhe çdo nioni e ka pasë edhe nga një litër qumësht. Filloi infrastruktura e “Trepçës” me u rregullue edhe e patëm bo atë restoran të ri. Po e thom edhe ni thanje të mahershme të atij Rexha Dervisheviqit.

Hini “Kabllari” i Kralevës me punue në banesa në Tunel të Parë. “Kosova” e Vushtrrisë ish atëherë ndërmarrje ndërtimore bukur e pregaditne mirë. Edhe p’i thom, “Drejtor keq bre”, tha, “Pse Ibush?” Thashë, “Po ‘Kabllari’ këtu po punon e ‘Kosova’ e Vushtrrisë...”. “Po ani çka po propozon?” Thashë, “Me ja dhonë ata le ta bojnë restorantin, le ta bojnë banjon e punëtorëve krejt ato”, tha, “Po mirë e kije s’ka problem. Ti veç propozo” tha, “une politikisht rri mas atyne.” {vendos dorën në gjoks} Tha, “Ti veç vazhdo”.

E qashtu patëm bo edhe pse ka qenë shumë vështirë me u shty me “Kabllarin” atëherë, por po e thom edhe niherë ai më ka respektu shumë, më ka respektu veç që kom punu për kurgjo tjetër. Se jo që jom konë i bukur ja dikushi, po veç që kom punue. Edhe e patëm fut “Kosovën” e Vushtrrisë aty, e patëm “Përparimin” për me sjellë ujin e pijes aty. Domethonë, nisëm dalë ngadalë me bo hapa që ishin në interes të regjionit tonë.

Anita Susuri: E i përmenda edhe ma herët këto parollat që kanë lindë ma vonë, mas vitit ‘85 po më duket kanë dalë këto parollat.

Ibush Jonuzi: Po, po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë atëhere gjendja, për shembull mas vitit '81, mas demonstratave veç ka fillu me u keqësu situata politike edhe kjo situata politike ka dërgu në marsh e në grevë.

Ibush Jonuzi: Po.

Anita Susuri: Po po më intereson krejt kjo qysh u pasqyru te ju si punëtor i “Trepçës” edhe te minatorët e tjerë, qysh e keni pa ju?

Ibush Jonuzi: Në “Trepçe” une kom thonë shumë herë, në depo të “Trepçës” veç aeroplana s’ke pasë. Edhe armatimin na e kena pasë në kuadër të minierës e kena pasë armatimin për vetëmbrojtje. Ka qenë sektor i veçantë, po ato raportet pas demonstratave të ‘81-shit ditë pas dite u ftohshin. Unë e kom pasë ni, ni kushterimin që edhe sot ka qenë ushtar i mirë në kohë të UÇK-së, ni Ali Jonuzi që osht’ plagos qitu {tregon mbrapa} nja 50 metra prej shpijave tona në kohë te demonstratave edhe në atë kohë ka qenë i punësum në “Elektro...” këtu në “Elektro Kosovë”.

E çojnë në spital prej spitalit e çojnë në burg, në burg të Smrekonicës. Une shkoj me vizitue në burg ato, e u bo qaq e madhe. Tani sërëbët thojshin, “Po i jepni pozitë Ibushit që e ka nacionalizmin në shpi të veten”. U bo shumë e madhe, po megjithatë po thom unë krejt ata i mposhtsha veç me punë, se punojsha ma shumë edhe s’kishin çka. Po, çdo ditë qysh e dijmë situata u rëndojke edhe në këtë aspektin politik. Pse?

I pengojke puna, i pengojke rezultatet e shiptarëve, i pengojke gjithçka. Ka qenë ni, ni drejtor, nifare Sreten Nikoliqi. Edhe njiherë në tubim punëtorëve po thotë, tha, “Po Ibushi e ka lehtë” tha, “ky” tha, “po vjen po punon”. Se ata minatorët thanë, “Vjen të shtunën, vjen dille, vjen natën, vjen ditën, ky s’nalët”. Edhe po më vjen keq me përmend, po tash po e tham që jam mirënjohës atij burri që e ka thonë, nifare Halit Haxha ka qenë teknik tha, “Lum djepi që e ka rritë këto” tha, “na dojmë udhëheqës që punon edhe udhëheqës që nuk na vjedh”.

Ai Sreten Nikoliqi desh plasi, se u konë shumë nationalist ka qenë. Tha, “Ky merr meditime”. Edhe e kryjti fjalën, une fjalën {ngrit dorën}, thashë, “Duhet m’u formu komision i veçantë” thashë, “për me verifikue une 30 ditë i ka muji, prej 30 ditë a i kom meditime apo i kom 22-23”. Edhe u bo komisioni. Thashë, “Nëse del veç ni orë e punës time që e kom jashtë orarit unë dho përgjegjësi para jush”. Po s’kish, shansë nuk kish, shansë nuk kish edhe u vërtetu që çdo gjo... Po ata e kanë pasë në shpirt nacionalizmin shkijet. Edhe në tubim të punëtorëve kur u diskutojke shqip, ata i pengojke. Kur dhojshin urdhna shqip atyne ju pengojke. Edhe qysh e pamë erdh situata çdo ditë tu u ranu ma tepër.

Anita Susuri: Edhe qysh ka ardhë tani deri te marshi, te qajo ditë? A u ditë që ka mu bo ni organizim prej minatorëve?

Ibush Jonuzi: Në shqyrtimet e amandamenteve kushtetuese, vishin delegacione prej Sërbisë, të ish-Jugosllavisë e tylifare edhe thashë aty kanë qenë disa minatorë që ma mirë kanë ditë me diskutue sërbisht sesa shqip. U konë nifarë Dragan Shapuniq s'ia kom harru emrin asniherë. Ishum në rend të parë ulun, nifarë Osman Rashica ni minatorë, dikun tash i ka të 80-tat. Përndrysh, ka punu ni kohë në Split edhe ai e dike gjuhën perfekt e dike gjuhën edhe i lexojke gazetatat.

U çu diskutoi për ndryshime amandamentale, këto, kjo, kjo, kjo, kjo, shumë e citoj. Edhe po më thotë, tha, "Drejtor çka o ky me profesion?" Thashë, "Minator" tha, "Osht' e pamundshme". Thashë, "Edhe ato minator me kualifikim, se as kualifikim të lartë ky s'ka". Po minatorët, kanë mendu njerëzit që kanë ditë veç me eksploatu xehen, po nuk ka qenë ashtu. Ata i kanë pa senet shumë larg i kanë pa. Edhe u shikë që për çdo ditë situata politike u rrënojke në Kosovë.

Edhe u bojshin ndalesa të punës, por jo për çashtje materiale, atëherë nuk ka diskutu kërkush në atë kohë për çashtje materiale. Se e thashë ma herët që u konë për çashtje materiale, për përmirësim të pagave, kurse ato vetëm për çashtje politike. Mas atyne ndryshimeve fillun lëvizjet, tubimet e puntorëve, "Kjo s'po vyen, kjo s'po vyen" edhe erdh deri te organizimi i marshit të minatorëve prej Stantërgut në Prishtinë.

Qysh e dini të gjithë, ai ka qenë një marsh shumë i fuqishëm, shumë mirë i organizum, pa asni eksces prej Staritërgut në komë, autobusat i kanë pasë të organizum s'kanë hyp në autobus ata. "Dojmë veç në komë me shku". E kur jemi shku në Gazimestan, këto e kom thonë edhe herave tjera, ka qenë kordoni i policisë edhe unë kom qenë në rend të parë aty. Në radiolidhje thojke, {afion dorën tek veshi} kuptohet sërbisht i thojke, "Nuk ka forcë që i nal". Edhe e kena thy kordonin e policisë edhe kena vazhdu përpara edhe ndrrimet tjera tani kanë pasu qashtu, marshet e minatorëve, kanë shku edhe në Mitrovicë edhe në Prishtinë edhe erdh deri te ajo që ju premtohet, "Ka m'u bo kjo, ka m'u bo".

Korab Krasniqi: A munësh me na spjegu qat' ditë? A je konë ti pjesë e grupit që ka marshu?

Ibush Jonuzi: Po, qysh jo.

Korab Krasniqi: Qysh u konë qajo ditë domethonë, kur je zgju, kur je nisë, çka keni komunikue mes veti, gjatë rrugës çka keni folë?

Anita Susuri: Qysh e ke marrë vesh që po shkoni fillimisht?

Korab Krasniqi: Ku keni shku e kështu me radhë?

Ibush Jonuzi: Dita ka qenë shumë e ronë. Ndrimi i tretë kur kanë dalë, nuk i kanë hjek teshat e punës po kanë pritë në sallë. Edhe jonë ardhë ndrimi i parë ju ka bashkangjtitë aty meniherë në sallë edhe osht' marr vendim, "Nuk dojmë mo me diskutu, kena me shku drejt për Prishtinë". Po ato zaher nuk jonë bo veç qat' ditë domethonë, jonë bo do parapërgaditje ma herët edhe kështu ka qenë pastaj kena fillue bashkarisht, që thashë ma herët edhe inxhinjerat edhe krejt jonë konë prej minatorëve. U konë edhe sërbja që u konë në atë kohë kryetare e...

Anita Susuri: Juljana Gashiq.

Ibush Jonuzi: Juljana Gashiqi, ajo u konë me minatorë, qashtu.

Anita Susuri: Po neve edhe na kanë tregu po e kemi pa edhe në fotografi që ka qenë edhe fotografia e Titos, flamuri jugosllav.

Ibush Jonuzi: Po, po, ka qenë, ka qenë. Se u dashtë me diçka m'u mbulue. Kqyre u dashtë me u mbulue me diçka. Kur thojke presidenti Rugova, thojke, "Duhet me mbrojt pragun e shpisë", a ka thonë qishtu? Nuk mujke me thonë ai që duhet me luftue, po edhe kur u bisedojke diçka me to për çashtje të luftës, të UÇK-së thojke, "Qe ku e keni profesor Aganin merruni vesh me to". Rugova kështu thojke, "Merrni vesh me to". Edhe unë po thom u dashtë m'u mbulue para diçkafit, para fotografie, para flamurit për me i realizue këto tjerat që thashë. Qashtu ka qenë.

Korab Krasniqi: Thatë që nuk ka pasë ndonji eksces përveç në Gazimestan që keni has në kordon.

Ibush Jonuzi: Asni eksces nuk ka pasë rrugës, as në shkurje, as në kthyrje. Në Gazimestan u konë kordoni i policisë osht thye kordoni edhe çdo gjo ka qenë...

Korab Krasniqi: Keni vazhdu, deri ku keni shku?

Ibush Jonuzi: Dej në palestër, "Boro Ramiz" ish "Boro Ramiz" atëherë. Kemi shku krejt aty, tani kanë fillu lëvizjet, jo veç të minatorëve po edhe të qytetarëve edhe të studentav edhe të minierave tjera, prej Kishnicës, prej Goleshit krejt kanë pasë... Atëherë ka qenë lëvizja e njerëzve sikur lumë u konë, tana anët. Po ju thom ni detaj, une i kom dajët në Stanovc, Cakajt, që prej shpisë i kanë pa kolonat e qytetarëve. Edhe i ka thonë nona djalit, "Çka po rri këtu? Dil me shokë shko!" (buzëqeshë) Ajo u deké plaka, djali sot osht' gjallë në pension edhe ai osht' sikur unë. Tha, "Po më thotë, 'Ça po rrin këtu? Dil shko me ta!'" Do të thotë, ka qenë qashtu një angazhim i madh i krejt, krejt njerëzve.

Anita Susuri: A të kujtohet ty kur keni ecë nëpër qytet, kur keni hi, qysh ka qenë reagimi njerëzve ose a e keni vërejtë këto?

Ibush Jonuzi: Jashtëzakonisht ka qenë i mirë, jashtëzakonisht. U shihshin ftyrat e njerëzve të disponume e të qeshura kur na pajshin ashtu edhe pse me ato tesha të punës, me helmeta, me këpucë të rona ato kanë qenë. Po thom, mjerim ka qenë me udhëtu prej Stantërgu në Prishtinë në komë, ajo u konë punë e rondë. Disa kohë atyne ju kanë bo krejt komët varrë nuk kanë mujt mo qysh thojnë me ardhë në veti prej atij mundimi të madh. Po mbi të gjitha, vullneti i madh për me bo diçka ata i kanë përballu edhe asajna.

Anita Susuri: A të kujtohet në sallë kur keni shku në "Boro Ramiz" kush ju ka pritë atje edhe çka o bisedu?

Ibush Jonuzi: Po ato kërkesat i dini të gjithë edhe Kaqusha ka ardhë aty, ka ardhë Remzi Kolgeci e tjerë ka pasë kështu, po që thojnë pak të rangut ma të ultë. Edhe u diskutu që s'ka me nguc kërkush as kushtetutën e Krahinës Autonome Socialiste atëherë që u konë. As s'ka me i ngucë kush minatorët, as amandamentet kushtetuese s'kanë me u ndrrue, qato qysh jonë premtue s'ka me dhonë kërkush dorëheqje se u shihshin ato pozitat edhe këto kanë qenë kryesisht fjalët edhe premtimet që kanë me u bo.

Anita Susuri: Ti vet çka ke menu, a ke pritë që ka me pasë pasoja prej qatij marshi?

Ibush Jonuzi: Po, po.

Anita Susuri: Çka ke mendu për shembull, çka ju pret?

Ibush Jonuzi: Kom pritë që ka më pasë pasoja edhe u ardhë njeri në zyre më ka thonë, njeri shiptarë që ka qenë nënkryetari i Këshillit Punues të "Trepçës". Tha, "Ti je inxhinjer i mirë, ti je udhëheqës, ti e ke kry fakultetin duhet me u rujt, duhet knej, duhet anej, këto s'na çojnë kërkun", sepse ai u shike që osht në tjetër vijë. Edhe emrin po ju tregoj s'ka aty, ashtu ka qenë, Braush Sejdiu ka qenë. Thashë, "Nënkryetar" thashë, "falemnderit për këshilla. Jom" thashë, "shumë i vetëdijshëm ç'a boj".

Thashë, "E kom kry fakultetin, jom babë i shtatë fëmive" thashë, "punoj qe sa vite" thashë, "e kom përgjegjësinë me ligj të xehëtarisë me qenë pranë minatorëve" thashë, "edhe asniherë" thashë, "nuk hekë dorë prej tyne". "Po, po veç" tha, "unë që po të due e që je punëtor e po të sugjeroj që ti me pasë kujdes". Do të thotë i kena ditë. Une i kom thonë grusë teme hala pa shku në burg që në burg kena me shku. "Jo more" i kom thonë, "Po, veç nona mos te dinë", qishtu ka qenë.

Ose u ardhë shoku i klasës teme Fadil Bajgora që në atë kohë ka punu në shërbim sekret të JNA-së. I ka fikë dritat e kerit qitu u ardhë {tregon djathtas}. Ka thonë, "Shoku jem kom obligim me të njoftue se shërbimi ushtarak o tu të përcjellë", tha, "une kurgjo s'di" edhe u kthy për rrugë. Thashë, "Falemnderit shumë Fadil" do të thotë jonë ditë këto sene, shumë i vetëdijshëm po thom edhe tash jom konë që pasojat kanë me pasu amo duhet dikun me koçitë, s'ka aty. Po thom edhe atëherë, po thom edhe tash u dashtë fatin me nda me ata minatorë.

Kur jom shkue në burg ka ardhë miku i vëllaut i ka thonë nonës, "Halla Syleme, a po mërzitësh?" "Vallahin, boll bre Asllan" tha, "Hiç mos u mërzit, ma mirë që o në burg me shokë se me pasë konë jashtë". Që realisht qashtu osht', nona knej thojke, "Bre loke m'u hoç kogja shumë dhimta". E po thom i kena ditë na ato sene, jonë ditë, se nuk jonë bo organizime veç aty për aty, ja-a. Ajo punë osht' punue, kështu mirë osht' punue.

Anita Susuri: Po më intereson...

Ibush Jonuzi: Mas...

Anita Susuri: Po?

Ibush Jonuzi: Mas tubimit, mas, mirë thashë tubimeve të nëntorit na e kishum ni mledhje të komitetit, ka qenë komiteti për vetëmbrojtje edhe erdh ni minator masdite, erdh atëherë ka qenë sekretari i drejtorit. Sinan Kurteshi ka qenë sekretar edhe i drejtorit edhe i jemi, tha, “Drejtor” tha, “ni minator po të thërret”. Dolëm prej zyrës shkova në zyre teme erdh ai minatori Tahir Salihu u konë që edhe ai ka qenë në burg me neve. Tha, “Drejtor jom ardhë me të pyt diçka, a kini me na mashtrë?” Për përgaditje të grevës është fjala.

Thashë, “Kurrë, kurrë me ju mashtru s’kena”, “Eh qaq” tha, “veç” tha, “te di prej teje”. Do të thotë, gjithçka atëherë po thom osht’ punu në mënyrë ma të mirë, ma të sigurtë, ma serioze, se nuk ka qenë lehtë. Ajo u konë atëherë pozitive e udhëheqësve, shumë e rëndë ka qenë. Une i kom marrë tremdhetë vendime për ekzekutim në burg. Erdh niherë ni djalë i ri në qeli, në dhomë me mue edhe ma prunë vendimin edhe p’e lexon. Tha, “Bre bacë nashta s’ju ekzekutojnë” thashë, Fatos e ka pasë emrin. Fatos Fazliu, thashë, “Paj bre Fatos nashta po, s’di ç’a dojnë me na bo”.

E ja nisi djalit p’i shkojnë lotët kështu {prek faqet}, kurrë s’i harroj lotët e tinaj. Do të thotë, ka qenë situatë shumë e rëndë, shumë e rrezikshme ka qenë në atë kohë që thashë ma heret me ja qit’ gjoksin shkaut nuk u konë bash lehtë atëhere. Me thonë ti je ti, na jem na, se na kena qenë grusht i vogël, Kosova. Po fatbardhësisht eci puna.

Anita Susuri: Qeto tre mujtë ndërmjet marshit edhe grevës...

Ibush Jonuzi: Po?

Anita Susuri: E di që kanë ardhë policia me marrë në pyetje njerëz, qysh ka qenë kjo, ju kanë marrë sigurisht edhe juve në pyetje?

Ibush Jonuzi: Po, po, ka qenë presioni shumë i madh i organeve të sigurimit shtetëror në atë kohë. Po thom, për mue më kanë marrë disa herë në pyetje edhe natën edhe, “Nuk bon ju duhet me punue e juvja osht’ me punue, ju jeni udhëheqës, keni përgjegjësi, minatorët duhet me i bind. S’ka me dalë në marshe, s’ka me pasë tubime duhet me punue”. Do të thotë, në qet’ formë ka qenë presioni shumë i madh. “Munesh m’u denue, munesh me e hup vendin e punës, munesh me pasë pasoja edhe ma të mëdhaja”. Qysh më kanë thonë mue, tana këto i kanë thonë.

Do të thotë, për mu ka qenë ni presion shumë i madh kohë mas kohe, se edhe e kanë ditë që unë jam shpirtnisht shumë i lidhun me minatorë. Atëherë me shkru ni “KR” në minierë “Kosova Republikë” në pluhun, minatorët e shkrujshin në pluhun, sa ekspedita e sigurimit vike aty, sa tmerri, sa telashja u bojke ose dikun me shpërthye naj gyp meniherë athue e kanë bo minatorët me qëllim. Po thom, ka qenë shumë e ranë.

Anita Susuri: A ju kujtohet, se po kthehemi pak mrapa, në vitin ‘86 i kanë arrestu dy minatorë për shkak se kanë shkrujt parollën “Kosova Republikë”, a ju kujtohet?

Ibush Jonuzi: Po kohë mas kohe i kanë arrestu edhe i kanë marrë shumë. Do të thotë, veç që e bojshin “Kosova Republikë” aty mule me i marrë. Edhe ata vishin me kontrollu, po thom edhe niherë në shkamb e shkrujke {bën sikur shkruan diçka me gisht}, ja në guri me gisht në pluhun. E fshijshin ata u kthejshin apet. Aty ka qenë e pamundshme me i kontrollu ata.

Anita Susuri: E thatë që minatorët, njoni prej minatorëve ka ardhë edhe ju ka vetë, a keni me i mashtru, domethonë që e paskit ditë në njëfarë mënyre që paska me u organizu një grevë.

Ibush Jonuzi: Po.

Anita Susuri: E keni ditë?

Ibush Jonuzi: Po u ditë ajo, qysh jo. Une thashë ai ka vetë, “A keni me na mashtru?” Unë thashë, “Jo, kurrë. Kurrë s’kena me ju mashtru!”

Anita Susuri: A ka qenë ni grup apo kush ka qenë organizator?

Ibush Jonuzi: Tetonë, ajo thanja që osht’ thonë, krejt jonë konë.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Qysh ka qenë para grevës qajo periudhë edhe qysh ka fillu greva qajo ditë qysh ka ecë? A u ditë saktë data apo ka ndodhë...?

Ibush Jonuzi: Greva, greva... ndrrimi i parë nuk ka dalë prej miniere. Une kom qenë në zyre kujdestar, se atëherë të gjitha ndrrimet ka qenë kujdestari. Do të thotë sistemi katërbrigador ka punuar në minierë. E para, e dyta, e treta, një ndrrim ka pushu. Pastaj qashtu, {lëviz duart në rreth} cikli osht’ mbyllë qashtu. Edhe mu më ka thirrë kujdestari, tha, “Drejtor” tha, “ndrrimi i parë nuk po del”. “Çka u bo Rexhë?” Tha, “Vallahi, nuk po del”.

Edhe as s’ka qenë Azizi aty, as s’ka qenë Burhani veç une jom konë edhe jom zdirgj meniherë une, i kom thirrë të gjithë inxhinjerët. Bile i thojshim zyrja e fundit (buzëqeshë) qashtu ka qenë emërtimi, në zyre të fundit krejt i kom thirrë. Thashë atij kujdestarit, thashë, “Thirri krejt inxhinjerët thuj, Ibushi po thërret”. Jonë ardhë aty thashë, “Duhet m’u caktu me shku të gjithë nëpër horizonte me bisedu me minatorët çka o në pyetje”.

Edhe në të nontin horizont u konë numri ma i madh i minatorëve, jom shku une vet edhe jemi shku të gjithë nëpër minierë. Ata kanë thonë, “Na kena vendos, na kena vendos me hy në grevë edhe nuk

dalim prej greve”. Qe qishtu ka qenë fillimi e pastaj janë informue të gjithë. Të gjitha instancat janë informue në atë kohë. A starti qeky ka qenë në ora 13:00 osht’ ardhë lajmi që ata nuk dalin prej miniere.

Anita Susuri: A mundeni tash me na spjegu krejt përjetimin e grevës, çka keni pa, çka ka ndodhë, qysh u pritë prej tjerëve?

Ibush Jonuzi: Në historik të minierave nëntokësore kjo ka qenë greva ma e gjatë. Tetë ditë e tetë netë me nejt në ato kushte veç kapaciteti i xehëtarëve për çashtje të Kosovës ka qenë përkushtim shumë i madh. Pse? Sa herë është bisedu, ata kurrë s’e kanë qit’ interesin personal, ja pagën përpara se interesin e përgjithshëm nacional. Hymë në grevë, ndrrimi i parë nuk dul, erdh ndrrimi i dytë u fut meniherë në grevë, erdh ndrrimi i tretë u fut përsëri në grevë. Ndrrimi i katërt që ka qenë në pushim erdhën edhe ata. Edhe fillunë lëvizjet e mëdhaja të njerëzve të tjerë, për shembull pensionista me hy në grevë, po ata jena përpyekë mos m’i leje.

Edhe na e bomë meniherë renin aty në minierë, kujdestaria në minierë, kujdestaria te pyrgy i minierës me hy. Kujdestaria në portë kush po hyn, kush po del. Se u konë shumë rrezik m’u infiltru dikush që me pasë pasoja shumë të mëdhaja. Aty kanë qenë sasi të mëdhaja të eksplozivit. Depotë për minim kanë qenë në të gjitha horizontet. T’u fillu prej horizontit të parë deri në horizontin e nimdhjetë. U dashtë, po thom, m’u konë shumë i përgaditun, shumë sy çelë për mos me ardhë deri te naj eksces. Edhe po thom tetë ditë e tetë netë edhe pse ata janë lodhë, kanë hongër pluhun, pa ushqim, tana po megjithatë i kanë përballu, fuqishëm i kanë përballue.

Ka pasë lëvizje tyne me dalë naj kontrollë të mjekut, edhe pse mjekët janë, edhe tash muj me qenë shumë falenderus, përkushtim, ju kanë ofru ndihmë minatorëve. Nuk dojshin në spital me shkue e kena bo në qat’ sallën e tubimeve nifarë spitali të improvizuar me do kreveta do, që aty me u vendosë se nuk dojshin as me u ofrue shërbime mjekësore. Po u bo alarm i madh në krejt Evropën se mos me thonë në ish-Jugosllavi, po në krejt Evropën u bo. Kur e pat thonë se në “Trepçe” po mbrohet ish-Jugosllavia e atëherë ka qenë çashtje e madhe.

Edhe delegacion mas delegacionit, delegacion mas delegacionit pa ndërpre. Ka qenë ni rregull që këto ma kanë thonë, në aktakuzë e kom pasë të ngarkume në burg që edhe shiptartë e kanë thonë po e kanë thonë do shiptarë frigacak që janë konë se, “Pa leje të Ibushit kërkush s’ka mujt me hy në minierë”. Edhe realisht qashtu u konë. Drejtori teknik osht’ teknikisht njeri ma i thirrun, ma përgjegjës për minierë. Ju lëshojshim ushqime kohë pas kohe. Delegacionet i lëshojshim me ren, jo veç me shkue më falni në shprehje si në pazar kujt t’i teket. Çdo gjo u përcjellë, po për çdo gjo na jemi konë të përcjellun.

Anita Susuri: Kon e keni pranë për shembull, kon e keni refuzu për me hi?

Ibush Jonuzi: Paj tetonë janë pranë me thonë të drejtën, kur ke çashtja këta me ardhë, kryetari i Komitetit të ish-Jugosllavisë që u konë atëherë Stipe Shuvari, edhe thanë, “Stipe Shuvari po don me ardhë”. Nuk jena tubu në sallë, po jena tubu në restorant edhe kryetari i Këshillit Punëdrejtues, ka qenë

Aziz Abrashi tha, “Po shkojna te minatorët me ju tregue që duhet me pranë Stipe Shuvarin”. Tha, “Edhe veç une e Ibushi po shkojmë”.

Vendim kryetari edhe hymë na në minierë, shkumë në horizontin e tetë. Ja nisi Azizi me ju fol edhe besoni më doket ai moment si m’u konë sot thojsha edhe shkëmbi po qet lot, ça bojshin tu qajt ata, minatorët. I luti Azizi hiç s’pranun, thanë, “Hiç, hiç nuk dojmë me ardhë këtu”. U tërhiqëm nja 20 metra edhe po ju thom, thashë, “Kryetar, a të ju thom une?” “Mule” tha “bre Ibush, mule thuju!” Jena kthye përmapa, ju kom thonë, me dy fjalë thanë, “Le të vjen”. Edhe e kanë pranue.

Anita Susuri: Qysh i ke bind?

Ibush Jonuzi: E nuk e di qysh (qeshë). Une thashë me dy fjalë jonë bindë ata. Ka qenë, ka qenë ni grevë e vogël në vitin 2015, se une 2014 jom kthy në “Trepçë” edhe niherë, kom qenë zavendës menaxher i krejt “Trepçës”. Edhe po më thotë ai menaxheri, “Vallahi Ibush, nuk po shkojshin minatorët në minierë”. Shkova i takova në banjo qaty, “Ani” thashë, “shkoni”, se u dashtë me ju ditë gjuhën atyre. Hynë ata në minierë, hynë në grevë, shkumë na, vishin do struktura të “Trepçës” erdh kryetari i Mitrovicës, Agim Bahtiri. Une e pajsha situatën qysh osht’ tu u zhvillu aty edhe kadale, kadale, kadale hina pak ma thellë mes tyne.

“A bon unë me fol?” “Bon”. Edhe ja nisa me folë. Edhe gjithçka murr tjetër kahje edhe u bindën që duhet qishtu me veprue, qishtu me veprue, qishtu po veprojmë. Mos me zgjat këtë, edhe Agim Bahtiri tha, “Kuku” më falni në shprehje, origjinal qishtu më tha, “Synin ta hongsha ça tek je ti”. Ata minatorët e vjetër mu më kanë njoftë mirë, jo veç që më kanë njoftë po më kanë dashtë e i kom dashtë e më kanë respektue. E qishtu edhe aty më kanë ndëgjue. Delegacion pas delegacionit për me i bind, me i bind që me dalë. Erdh ni delegacion i ish Armatës Jugosllave, ka qenë... me m’u kujtu emri tinaj tash... a e kom dikun të shkruem {shikon në telefonin}. Vallahin dikun e kom pasë të shkrum emrin e tinaj.

Anita Susuri: Po, nejse, postin po ia dimë çka ka qenë.

Ibush Jonuzi: Edhe këta të Kosovës të Komitetit, shkuem Azizi, Burhani, une edhe Bahredin Osmani ka qenë kryetar i Komitetit Komunal të Mitrovicës me bisedue do të thotë me atë nivel ma të naltë të ish Armatës Jugosllave. Une kom qenë me tesha të punës, me helmetë, me çizme, qysh hihet në minierë qashtu jom konë, qashtu jom shku menihere edhe ja nisën me folë. Une thashë, une e mora fjalën thashë, “Kush e merr përgjegjësinë që me u myt ata 1300 punëtorë?” Thashë, “Ka eksploziv, ka kjo, ka kjo. Munën me ra në pusore, bjen kjo, vjen kjo”.

Bahredin Osmani që ish, kryetar i Komitetit Komunal, tha, “Ibush kadale, a e din kush o ky?” Thashë, “Po hiç s’po më intereson kush o ky”. A din, se mu më interesojke për minatorët, se jo për ato edhe përfundum bisedën une prapë drejtë edhe shkova në Stantërg. Delegacion pas delegacioni edhe për me bind edhe në anën tjetër për me na kërcënue çka munët me pasë pasoja kjo. Por, sidoqoftë mas tetë ditëve e tetë netëve ata dulën, dulën të mashtrumë. Tonëve na mashtrun sepse kërkesat nuk u plotësun, dorëheqjet nuk ishin reale që i dini të gjithë.

Po fallco. A efekti, se më kanë pyt shumë, “A osht’ arritë?” Efekti osht’ arritë. Efekti i grevës osht’ arritë, dhanë dorëheqje, s’dhanë dorëheqje efekti osht’ arritë sepse osht’ shku synimi në vend. Edhe pamë, jemi dëshmitarë të asaj kohe edhe pse ju jeni të ri, prej atij momenti gjithçka ka ndrrue në vazhdimësi te Kosova. Se ju ka dhonë goditje ma të fortë greva e minatorëve ju ka dhonë ish-Jugosllavisë. Fillun minatorët mas leximit të atyre dorëheqjeve me dalë, që ka qenë e tmerrshme me pa. Edhe ka qenë e rrezikshme me metë pa të pame, pa... megjithatë, pasoja ka lonë, gjurma shëndetësore ka lonë te të gjithë, po mbi të gjitha edhe një herë po thom osht’ arritë efekti i... e...

Anita Susuri: Veç deshta me ju pyt, qysh u pritë ai lajm, se atëherë keni mendu që osht’ e vërtetë, për qato edhe kanë dalë...

Ibush Jonuzi: Po, po.

Anita Susuri: Qysh u pritë ai lajm që kanë dhonë dorëheqje?

Ibush Jonuzi: Po mirë u pritë, mirë u pritë sepse po thom edhe njëherë nuk ka qenë lehtë me nejt aty. Në kushte normale veç pesë minuta m’u nalë rryma, mos me punu lifti aty u bojke alarm, “O s’ka rrymë, qysh me dalë tash?” Miniera i ka specifikat e veta, aty u konë në horizontin e nimdhetë osht’ 15 metra mbi nivelin e detit, domethonë 800 e kusur metra nuk osht’ bash, “Hajde se bohet, s’bohet”. Po sidoqoftë osht’ menue që kanë dhonë dorëheqje reale, s’kanë dhonë dorëheqje po edhe një herë po e përsëris efekti i grevës osht’ arritë, plotësisht osht’ arritë.

Mas daljes minatorëve pastaj kanë fillu marrja jonë rend në burg. E dini edhe atë periudhë, edhe ka pësu edhe Azem Vllasi që ka qenë veç vizitor në minierë. Edhe t’u fillu prej Azizit, Burhanit, une, Mensuri, Riza, ata minatorët, Avdija e minatorët tjerë, kemi nejt 14 mujë në burg. Kemi marr ka tremdhetë vendime, disa kanë hy ma vonë. Bile njoni rahmet shpirti i pastë {vendos dorën mbi gjoks} më pyeti, edhe pse ka qenë me moshë ma i vjetër se une, tha, “Bacë, me të pyet diçka drejtë”. Thashë, “Urdhno?” tha, “Pse mu më morrën gjashtë mujë ma vonë?” thashë, “A me të kallxu drejtë?”. Thashë, “Ja u ke lonë as anej, as anenaj” thashë, “me ju pasë kallxu shkurt veç qishtu, ata të kishin marr ditën e parë”. Ja nisi me keshë (qeshë) realisht qashtu u konë.

Anita Susuri: E qysh ndodhi qajo, qai arrestimi juj? Ku ju kanë marr? A ju ka ardhë vendimi paraprakisht?

Ibush Jonuzi: Arrestimi im ka ndodhë kështu, une në atë kohë e kom pasë telefonin {tregon telefonin}, telefon mobil se s’ka pasë kësi. Përndrysh, ka pagu “Trepça” atëherë 170 mijë marka për me ma pru mu telefonin në shpi, kërkush s’ka pasë telefon ksajde. Pse? Me ligj ti nuk ke mujt me qenë udhëheqës aty, drejtor teknik pa e pasë telefonin, ligji ka qenë i xehëtarisë që ti u dashtë gjithmonë me qenë në kontakt me minierën. Edhe ka pague “Trepça” 170 mijë marka, bile ish drejtori atëherë që ka qenë i postës, tha, “Po thom, kush osht’ ai njeri me u pague gjithë kjo pare?” Më thojke, “More Ibush unë s’e dita që je ti”.

Më ka thirrë në telefon njëfarë iksi, shiptarë u konë tha, “Jom filani, qishtu, qishtu”, s’po du me ja përmën emrin se nashta s’nihet mirë, se nihën këto sene, se tjerët a e pe i përmëna krejt une. Tha, “Jom filani” tha, “kom ni urdhër me ardhë me të marrë, a të vi të marr në shpi, a qysh me ja bo?” Thashë, “Ja-a, mos hajde në shpi ti”. Qitu u konë {tregon me dorë majtas} ajo pompa e benzinës te rrethrotullimi, kom thonë, “Une dalë te pompa e benzinës”. Ish konë me ni fiqë të bardhë, jom hi në fiqë, më ka çue te gjykatësi hetues, më kanë marrë në pyetje rend, rend, rend. Edhe më kanë çu në qeli meniherë. Qishtu ka qenë marrja ime.

Anita Susuri: Sa ditë mas grevës jeni arrestu?

Ibush Jonuzi: Mas grevës, me të parin na kanë marrë, tani edhe mu më kanë lonë nja dymdhetë ditë kështu në pauzë. A çdo ditë u dashtë me u lajëmruë në Sigurim Shtetëror. Qishtu ka qenë marrja.

Anita Susuri: Çfarë aktakuze e keni pasë?

Ibush Jonuzi: Aktakuza ka qenë shumë e rondë. Thashë, thashë ma herët kështu gjatë bisedës, tremdhetë vendime i kemi marrë për ekzekutim, une për veti që i kom lexu i kom edhe vendimet dikun. Thojke, “Nuk ekziston mundësia e zbutjes së këtij dënimi kurrsesi”. Ka qenë drejtor ni shiptar atëherë, nifarë Shera, Sherafedin Ajeti. Edhe na çunë në një qeli tjetër me një, me një shiptar të Beçiqit, që ish edhe dhondërr i fshatit tim. Kurrë nuk... mo mas luftës s’dihet ka osht’ ai.

Kur na çunë në atë qeli ishin konë do qebe të kaltërta në ata kreveta edhe po më thotë, tha, “Bacë kur dalum prej këtuhit?” Tha, “Që dalum këto qebe kom me i marrë”. Thashë, “Leje bre Hajriz, çfarë të marrni”. Tha, “Bacë, kom me i marrë”, “Po leje bre, mos na bo telashe. Hiçmu tyne!” “Bacë” tha, “këto kom me i marrë gjithqysh”. Mos me zgat, mas disa dite thojnë, “Hajdeni tjetër qeli”, se qashtu ata të maltretojshin, poshtë, naltë, herë në ato, herë në ato. Ai qebet në sjetull {bën sikur vendos diçka ndër sqetull}. Kur shkumë në qeli, aty i mur qebet i shtroi në krevet temin.

Thashë, “Pse Hajriz?” Tha, “Jo këto i kom marrë për ty une, jo për veti”. Erdh drejtori i burgut e çeli derën e qelisë. Tha, “I kujna osht’ ai krevet?” Thashë, “I jemi osht’”. “Ato çebe?” Tha, “Une i kom marrë”. “Kush je ti pis?” Tha, “Une i kom marrë” tha, “ky duhet me u dallu prej neve. Ky” tha, “nuk osht’ sikur na”. Edhe met ai pa tekst met, drejtori i burgut, mirë thashë drejtori i burgut. Po thom, aty në burg ka pasë gjithçka. Domethonë, siç e përmëna atë rastin që i shkunë lotë {prekë faqen}, kur e lexoi vendimin për ekzekutim. Ka pasë raste që t’i kanë çu veçantë veç çka po flitet, çka po thuhet. Erdh njëherë njo edhe po thotë, tha, “Hajt trego diçka për ‘Trepçën’”. Thashë, “Po ti s’merr vesh për ‘Trepçe’, me pasë thonë për naj dhi a diçka, se ti çka merr vesh për ‘Trepçe’”. Edhe qashtu përfundoi.

Anita Susuri: E a e keni ditë ju, a jeni konë të informum konë tjetër e kanë arrestu?

Ibush Jonuzi: A po qysh jo. Po se në aktakuzë krejt emrat kanë qenë, jo po krejt i kena ditë na.

Korab Krasniqi: A ka pasë komunikim ndërmjet juve?

Ibush Jonuzi: Nuk ka pasë, une kom qenë ni kohë të gjatë me Azemin veç murin e kemi pasë kështu në mes. Edhe Azem Vllasi, asniherë nuk u ra në gjumë për pa i mshu murit {bën sikur troket}. Se na i kena pasë do sheja që kena mujt kështu veç me sheja me komunikue. Kurrë Azem Vllasi nuk u ra në gjumë në qeli të veten pa mu lajmëru mue. Bile kur shkojshim në gjykim thojke, “Po tonëve, po ty Ibush s’kanë ça me të bo” thojke, “Po ti je punëtorë, ti je kështu, ti je... po ty” thojke, “kurrë s’kanë ça me të bo”. A din, nifarë mbështetje morale ta dhojke.

Anita Susuri: Na ka tregu, bile bash po më kujtohet Avdi Uka që mbrojtja kur ka qenë e ju domethonë, gjithkush ka folë për tjetrin, s’e ka mbrojt veten po...

Ibush Jonuzi: Po.

Anita Susuri: Dikon tjetër, domethonë mes veti.

Ibush Jonuzi: Po.

Anita Susuri: A ju kujtohen qato ditë?

Ibush Jonuzi: Na kemi qenë 14 vetë, avokatë nuk e di sa jonë konë, a jonë konë 50 a 60 për nder nuk e di sa. Përndrysh, për mu ka ardhë avokati prej Sllovenisë, as s’e kom ngjoft as s’e kom ditë. Ai veç në bazë të leximit edhe ish konë ardhë te vëllau thotë, “Qishtu jom filani, avokat, jom ardhë” thotë “me mbrojt”, thotë, “nëse jeni të pëlqimit” thotë, “me mbrojt Ibush Jonuzin”, thotë, “për kurgjo tjetër veç që kom dëgju për to që osht’ punëtor i madh” thotë.

Edhe vëllau ka thonë, “Po, ta dho pëlqimin”. Vjen ai në burg me më vizitue, avokati. “E qysh je, si je?” “Mirë krejt”, “A ka diçka?” Thashë, “Vallahi, veç nonën s’e kom pa”. “Qysh?” thashë, “Nonën s’e kom pa, i kom pa” thashë, “vllaznin e grunë e” p’i tregoj kështu. Thashë, “Nona osht’ plakë” edhe ai meniherë shkon në gjykatë edhe ja dhojnë lejen, kuptohet ai u konë slloven, nuk u konë shka. Ja dhojnë lejen që me ardhë edhe nona në vizitë edhe vjen më tregon. Thotë, “Nona ka me të ardhë në vizitë” thotë, “t’i veç mos u mërzit”.

Ja nisa unë m’i tregu, “Ti s’ki nevojë” tha, “kurgjo me më tregue” tha, “une krejt e di kush osht’ Ibush Jonuzi”. Tha, “As nuk jom ardhë për mjete”. Ni kafe nuk ka dashtë ai familja jem me ja pague, a din sa ni kafe. Ka thonë, “Hiç as ni kafe, prej principit nuk due, veç jom ardhë me mbrojt vullnetarisht veç që kom dëgju për to”, po thom ka pasë shumë avokatë. E avokatë kanë thonë, “Ai ka qenë gjykim karakteristik, 14 vetë mos me akuzu asnihere njoni-tjetrin veç me mbrojt njoni-tjetrin veç qeky gjykim ka ndodhë, në judikaturë” thotë, “nuk mahet në men”. Që realisht ashtu ka qenë.

Kurrë na s’kena folë, “Valla boni ky kështu ose ka bo ky kështu” veç jena konë, shumë unik kena qenë. Pa e ditë, pa u marr vesh. Po i kish pasë thonë nonës njo, “Hiç mos u mërzit halla Syleme që o në burg” thotë se, “ai osht i drejtë” thotë, “edhe njeri i drejtë” thotë, “ç’a të thotë, niqin herë flet” thotë, “niqin herë e thotë të vërtetën”. Thotë, “Hiç mos u mërzit, e thotë të vërtetën edhe s’kanë ç’a mi bo”. Për me

thonë të vërtetën osht lehtë, gjithmonë të njejtat pika ja qëllon njeri, a me ja nis me gënjye, me deviju atëherë sun ja qëllon kurrë.

Korab Krasniqi: Veç dashta ni pyetje. Me të kthy mrapa edhe pak...

Anita Susuri: Veç më fal, se e jemja osht' lidhur me qeto...

Ibush Jonuzi: Po.

Anita Susuri: Dhunë fizike ndaj juve s'kanë përdorë a po?

Ibush Jonuzi: Në burg, ja-a.

Anita Susuri: Veç psikike?

Ibush Jonuzi: Veç psikike.

Anita Susuri: Çfarë biseda kanë qenë, çka ju kanë pyet, çka ju kanë folë?

Ibush Jonuzi: E çka na kanë pyet, çka na kanë fol ajo është... Më nxjerri niherë p'i qelisë edhe te gjykatësi hetues ishin ardhë krejt advokatë aty, jo krejt nashta ja teprova, po plotë salla. Beso, s'i pajsha kështu. Edhe gjykatësi hetues ka qenë ni Avdi Dinaj, që i mirë u konë, edhe atëherë i mirë edhe sot osht' i mirë ai, po koha u konë qashtu. Ja nisi me më pyet, "Ibush knej-anej" thashë, "Une çka e kom pasë e kom thonë" thashë, "une mo s'kom çka me shtu kurgjo, bash s'kom kurgjo çka me shtue".

U çue i ndjeri Bajram Kelmendi tha, "Të lumtë!" Qishtu, "Të lumtë," tha, "Ibush! Çka p'e maltretoni" tha, "njerin. E ka dhonë" tha, "deklaratën e vet. Ju" tha, "hala p'e maltretoni". Aty të kanë maltretue, të kanë... une kom qenë i vetmi prej grupit të 14 që më kanë çu në burg në Beograd. Pse? Erdh avokati e kom pasë Adem Vokshin avokat, thashë, "Qysh o gjendja avokat?" P'e pys, tha, "Po Ibush kanë thonë dytë pa shpirt, njo i pa kokë". Po s'guxojke edhe me fol ai në qeli, në ato sallat e burgut u përgju gjethçka.

Edhe kqyrke kështu {shikon përreth} me më dhonë sheja që... Tha, "122 dëshmitarë" tha, "kanë dëshmu për ty" tha, "edhe dëshmitë" tha, "janë" tha, "muj me t'i pru me i lexue" tha, "janë që mos vet". Që thashë kanë dëshmu që aty kërkush s'ka mujt me hy në minierë pa thonë Ibushi. Domethonë, ajo u konë dëshmi shumë e ranë, domethonë krejt përgjegjësinë e kanë hudh në mue. Tha, "Po e shohum". E më kish pasë dëshmue nifarë nifarë sërbi i famshëm që ka qenë shumë i papunëtorë, që, "Jo organizimin e grevës, po edhe numrin e këpucëve të minatorëve ja u dinë".

Domethonë, me ni fjalë ju ka thonë gjithçka edhe më futën mu më çunë për Beograd, në burg me ni 101-sh, ni mbikëqyrës i burgut që u konë sërbi, ni vozitës boshnjak më çunë në burg. Në Beograd ishin konë dy në qeli aty, hina. Kushtet ishin konë shumë ma të mira se në Mitrovicë. Më falni në shprehje,

nashta edhe nuk osht' me përdorë, po nevojën fiziologjike u dashke qaty në qeli me, me krye. Edhe qaty me majtë kokën, ajo ka qenë tmerr maltretim, tmerr ka qenë, po thom edhe niherë tmerr u konë.

Në Beograd ishin konë kushtet në qeli krejt ma të mira, ata dy, hina në atë qeli u përshëndeta, më pytën, "Kush je?" Thashë, "Filani jom". Tha, "Krejt e dimë". E kishin pasë gazetën me ngjyra që jonë konë atëherë. Tha, "Jo, e dina krejt për juve". E ja nisën ata me më marrë në pyetje. Edhe pa dashtë, se s'kom dëshirë me i thonë këto të Beogradit, kom pasë thonë me mujt me më kthye në Mitrovicë në burg, kurrë mos me më liru mo s'mërzitna, kurrë s'mërzitna mo.

Um kthyn, tu u kthy rrugës... pata nejt dy javë ditë veç, a dy javë, a 18 ditë a, vallahin tash... edhe i thotë ai mbikëqyrësi, "Nalu e blejna bureka", atinaj vozitësit. U nal djali blejti bureka, ma pru, thashë, "Ja, nuk e marr" edhe nuk e kom marrë burekun me hongër. "A të kanë rrehë a?" Thashë, "Jo, jo, jo", ai sërbi po më thotë, "A të kanë rrehë?" Po isha teshë une, s'mujsha që thojnë frymë me marrë. Thashë, "Ja, ja s'më kanë rrehë, po s'e marr", "Merre, merre" thashë, "Ja, ja nuk e marr".

Pasha Zotin s'e kom marr burekun, e kom përmën sa herë këtë punë une. Ata nashta dytë jonë gjallë sot amo nuk ja kom marr burekun prej principit, s'dojsha hiç. Më kanë kthy në Mitrovicë edhe m'u ka dok sikur me ardhë në shpi. Kur ta çelke derën e qelisë shiptari, të përshëndetke, kur ti ngjitke prangat {kryqëzon duart} thojke, "Po më vjen keq lbush po urdhën osht". Thojsha, "Hiç s'ka problem, hiç kurrfarë problemi s'ka".

Jom helmu me ve në burg, më kanë çu në spital natën, se atëherë ti s'ke pasë mundësi me ditë çfarë kohe osht', s'ke pasë as orë as kurgjo s'ke pasë. Gardiani u dashke me nejt te dera e dhomës në spital. U ardhë nifarë mjeku, nifarë Sylë Hajdini e ka pyet gardinanin, "A bon me u afrue te lbushi?" Në burg të Mitrovicës. Ka thonë, "Po afrohu". "A bon ti me u largue pak?" Ka thonë, "Mirë". Erdh tha, "Çka po don me të ble me hongër?" Kuptohet, thashë, "Kurgjo s'po du doktor", "Jo diçka duhet" se u helmova qaq keq që ni kohë shumë të gjatë mo vetë kurrë s'i kom pasë hongër.

Edhe as vet s'di ça kish pasë ble, kur i pruni në ato keset që i dini edhe ju, gjithçka pruni amo nuk mujsha me i shti në gojë. Po jom shumë mirënjohës shumë faleminderus edhe gardianit të burgut që domethonë sakrifo, sakrifiko punën e vet, detyrën e vet për mue. Edhe mjeku që nuk ka mujt me i bo gjithkush ato punë. Po thom jom konë, gjithçka ka pasë po sidoqoftë ajo koftë e shkume e harrume.

Korab Krasniqi: Dashta me të pyt me u kthy edhe niherë te greva. Te kërkesat janë konë dhetë, nimdhetë përafërsisht.

Ibush Jonuzi: Po, po.

Korab Krasniqi: Jonë konë disa drejtimeshe, disa janë konë politike, disa janë konë për drejtat e shiptarëve, disa kanë pasë të bojnë me të drejtat e punëtorëve për shembull që i kanë penzionu ma herët, kuadrot e mësuesave shiptarë e kështu me radhë. Qysh jonë përpilu qato, qato kërkesa se më doket ato janë përpilu deri sa jeni konë në zgafellë, ato jane bo publike mandej.

Ibush Jonuzi: Po, po.

Korab Krasniqi: A mundësh me na kallxu qysh jonë përpilu edhe qysh i keni bo publike, qysh i keni bo të ditura kërkesat?

Ibush Jonuzi: Ato jonë, jonë përpilu pak ma herët kështu prej, jo prej të gjithë minatorëve, po prej ni grupi pak ma të ngushtë. Siç u konë kujdestaria nëpër çdo horizont që thashë ma herët, kujdestaria në hyrje, kujdestaria te porta, të gjitha aty jonë përpilu kërkesat. Jonë lexu para gazetarëve edhe pastaj ato kanë qenë kërkesa legjitime të minatorëve. Qishtë ka qenë shkurt, a din. Ato janë konë kërkesa të tyne.

Anita Susuri: Po a keni pritë ju që kanë me u arritë qato kërkesa, a ka qenë ma shumë veç për me ngrit vetëdijen?

Ibush Jonuzi: Paj... erdhi Boris Savioviqi në vitin '88 në Stantërg. Boris Savioviqi në atë kohë ka qenë kryetar i ish-Jugosllavisë. Edhe Azizi ish kryetar i Këshillit Punëdrejtues të "Trepçës", Aziz Abrashi. U bisedu qysh me vepru, qysh me pritë, ça me fol. E kur ke çashtëja e prodhimit, tha, "Ibushi duhet me raportue për prodhim", tha, "se ky o pis!" {ngrit gishtin tregues} qishtë ja boni. "Ky oshtë' pis" tha, "ky e mbyll minierën s'e ka dert", origjinal p'e citoj thonjën e Aziz Abrashit të ndjerë.

Ato jonë konë çështje që për "Trepçe", jo sikur sot m'u nalë "Trepça" edhe mos me ja qajt hallin kërkujna. Po veç ni ndrrim me u nalë prodhimi ish-Jugosllavi u shkojke lajmi në nivelin ma të lartë. Hej "Trepça" m'u nalë! "Trepça" ka punu edhe në kohë të luftës, domethonë Luftës Dytë Botërore ka punu, une i kom pasë krejt rezultatet qysh ka shku prodhimi në atë kohë. Edhe kështu ka qenë kjo punë.

Anita Susuri: Ka qenë edhe ni grevë e dytë që oshtë' mbajt për juve që jeni konë të burgosun.

Ibush Jonuzi: Po, po.

Anita Susuri: Prej njerëzve që kanë ardhë me ju vizitu ose... se e di që gazeta s'ju kanë lonë, po a ke marrë vesh në naj mënyrë që po ndodhë edhe kjo grevë ose çka po ndodhë jashtë?

Ibush Jonuzi: Greva e dytë, na kemi qenë në burg atëhere, mu më kanë nxjerrë prej qelije edhe më kanë çu në Staritërg, sigurimi shtetërorë me polici, me polici civile, jo polici me uniformë për me i bind minatorët që me heqë... Nuk kanë qenë në minierë atëherë, ata kur unë jom shku po ka qenë në restorant të minatorëve. Edhe une ju kom thonë shkurt, po ata që thashë t'i kanë lexu letrat në xhep. Masanej më kanë thonë, "Drejtore ditëm mirë qysh o situata, po ti na kallxove shumë shkurt".

E pastaj kanë hi në minierë ajo greva tjetër që me dhunë i kanë nxjerrë ata. Policia i ka nxjerrë me dhunë. Ata në restorant kur kom shku kanë qenë qishtë. E qysh i kanë maltretu ata, ata veç kanë tregue, se unë nuk kom pasë mundësi me ditë ato. A që the forma informimit, une e kom marrë "Rilindjen" çdo ditë në burg, u parapagujsa edhe ta bike, po ta bike të censuruar, ato që ishin për me i ditë na ato i

prejshin qishtu {bën sikur pren me gërshtë}, i sakatojshin. Kaniherë s'kishe kurgjo ça me pa, naj sport ose diçka kështu thjeshtë se kurgjo s'kish se krejt cenzurë bojke.

Mu më kanë shkru në burg shumë letra edhe motrat edhe vllaznia. E kom pasë djalin në shkollë të mesme e çdo ditë, po menoj shkrujke ai, ka qenë, "U pyta në këtë landë, mora pesë, kështu, kështu, kështu" {bën sikur shkruan}. Edhe po më thërret ni ditë qai drejtori i burgut, tha, "Çka o kjo punë?" Thashë, "Pse?" "Gjithë kjo letër" thashë, "Po ç'a ka lidhje gjithë kjo letër?" "Ça ka me shkru ai u pyta, s'u pyta", "Po ai osht' djali jem" thashë, "ai don me më informue". Po thom ka pasë maltretime, po mos të lëshohem shumë në detaje se jonë...

[Këtu ndërpritet intervista]

Korab Krasniqi: Kur të morën prej burgut e të çunë në Stantërg e takove grupin e minatorëve në restorant.

Ibush Jonuzi: Po, po. Në restorant po.

Korab Krasniqi: Të minierës.

Ibush Jonuzi: Po.

Korab Krasniqi: Çka të kërkun ata me ju thonë ti minatorëve?

Ibush Jonuzi: Ata prej mue, prej meje kërkun që, "Ti ki autoritet mi minatorët, e ti duhet me ju folë që ata me hjekë dorë, me hjekë dorë, me hi në prodhim, me hi në punë, me hi në minierë me prodhue e jo m'u marrë me grevë". Qe qekjo ka qenë kërkesa edhe presioni te une.

Korab Krasniqi: Çka ju thajë ti kur i takove minatorët, qysh e kuptun ata që je konë i detyrum?

Ibush Jonuzi: Thashë, thashë, "Po më vjen keq", thashë, "Po më vjen keq" thashë, "që jeni këtu". Thashë, "E mira e së mirës është ju me qenë në punë" thashë, "Puna osht' për minatorë, miniera e pret minatorin". Qishtu, qeto fjal. Unë e disha gjuhën që ata... po, po thom sinqerisht edhe ma kanë thonë shumë prej tyne, "Na e kena ditë qëllimin tond qysh e ki" edhe as s'kanë hekë dorë as kurgjo. Edhe jom kthi përmapa apat në qeli më kanë çu edhe përfundoi qashtu.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Po më intereson dita e gjykimit, vendimi po menoj kur u marrë e dimë që keni pritë, ju personalisht jo, po kështu, që ka me pasë pasojë shumë të madhe që keni me mbetë në burg e...

Ibush Jonuzi: Po, po, qashtu.

Anita Susuri: Ka qenë edhe ajo për ekzekutim. Qysh ka qenë për juve qajo ditë kur e keni marrë lajmin që po liroheni?

Ibush Jonuzi: U dashke me bo mbrojtjen me pregaditë mbrojtjen me shkrim, edhe më rajshin naj fjalë natën në men, kuptohet i preokupum i marsha, i shkrujsha qashtu në terr, se aty s'ke pasë dritë veç kur ka dashtë me ta ndezë dritën, kur ka dashtë me ta fikë. E shkrujsha për me përpilue mbrojtjen, u konë nifarë Riza Musliu, rahmet shpirti i pastë ka vdekë jurist edhe ai u konë me neve në burg. Edhe kom pasë shprehi gjithmonë me shkruie. Kurrë une për 20 vite në minierë nuk ka hy punëtor minator që unë s'e kom shkruie, "Erdh filani, e pat qet' kërkesë, ora kaq, dita kaq" që thashë gjithçka ja qitsha me me letra.

"Ibush" tha, "ça paske bo ti" tha, "ni jurist munët me doktorue me qet material tonin". Edhe ni detal du me ju tregue, gjatë seancave gjyqësore avokatit tem Adem Vokshit ja vrainë babën. Ja vrainë babën para derës shpisë në Pejë. Edhe u ndërpre gjykimi shkumë në seancën e radhës, kur filloi seanca une kërkoja fjalën prej kryetarit trupit gjykues, Ismet Emra ka qenë atëherë. Nuk e di a osht' gjallë, a s'osht' veç...

Anita Susuri: Jo, s'osht'.

Ibush Jonuzi: E çova dorën tha, "Urno, Ibush" unë drejt në foltore. Se s'dashta prej venit edhe p'i thom, thashë, "Dola" thashë, "me i shprehë ngushëllime avokatit të nderum Adem Vokshit për vvarjen, për vrasjen mizore të babës tina në prag të shtëpisë edhe faleminderit" u ktheva në vend. Aziz Abrashi tha, "Ibush" më falni në shprehje tha, "na ke kajt nonën, ka pesë vjet na i ke shtue". Thashë, "Une temën e thashë kryetar".

Qe edhe kjo po thom sinqerisht, ma ka çu dikush fotografinë prej Gjermanisë edhe sivjet ma ka çue, kah u sillë, qysh u sillë për nerë as vet s'di. Veç ma ka çu fotografinë kur jom dalë në foltore që e kom thonë qet' detaj, qet ngushëllim. Edhe kjo nuk u konë bash e lehtë me dalë para krejt atyne, domethonë ja kishin vra shkijet une dalsha m'i shpreh ngushëllime në foltore. E këto jonë konë momente që nuk harrohen.

Anita Susuri: Qysh ka qenë, a u konë gëzim, sigurisht jeni gëzu?

Ibush Jonuzi: Momenti?

Anita Susuri: Po.

Ibush Jonuzi: Momenti kur jena dalë nuk, nuk kom mujt me kuptue po thom sinqerisht, se mu doke e pakapshme. U lexue vendimi krejt, amo thojsha osht' e pa kapshme. Kur dulëm, na çunë në qeli me i marr qato ça kishum tesha e sene. Edhe pse atë ditë na thanë, "Veshnu mirë". U dashke do tesha

kështu me i majtë pak ma të veçanta. Edhe kur u lexu vendimi që liroheni, të pafajshëm, po thom nuk kom mujt me kuptu a din, u konë gëzim i madh se na pritshum për ekzekutim e tash...

Anita Susuri: Po.

Ibush Jonuzi: Po presioni i madh i faktorit të jashtëm i ka bo ato, se Sërbia e ka pasë qëllimin neve me na, a din që thojnë me na fshi prej tokës të dheut, se apet po kthena te ajo e para, ajo ka qenë goditje e madhe e Sërbisë. Kur dulëm masë e madhe e njerëzve, nuk dishe, sikur lumë ka qenë e mbulume Mitrovica, vëllau ish konë dikun me kerr edhe një kurrë s'e kom ditë kush osht', kurrë as sot as atëherë s'e kom ditë. "Drejtore, hajde bre, hajde bre në kerr temin, qe ku e kom kerrin. Qe ku e kom kerrin bre se po kom qef, hajde, hajde". E i thom edhe dhondrit, thashë, "Prite qitu Hetemin, vëllaun dej të vjen" thashë, "se gjithë atë rigja [lutje] që ma boni".

E më ka qit' në kerr, e më ka çu për Zveçan, atje ka Dedin Krshi, kur jena ardhë te vorrezat e sërbeve në Mitrovicë, rruga që vazhdon knej për Prishtinë i kom thonë, "Allahile nale, nale burrë" thashë, "se ata i kom familje teme". Pasha Zotin kurrë s'e kom ditë kush osht'. Domethonë, më ka marrë me kerr veç... edhe kanë tregu edhe nëpër kulma ka pasë, kulma të banesave, nëpër tarasa të banesave edhe sigurim polici po njëkohësisht edhe qytetarë. Po thom, ajo u konë ni gëzim jo veç për neve, po po e shprehi kështu, ai u konë gëzim për gjithë kosovarët sepse u konë goditje drejtë për së drejtë e sistemit gjyqësor të Sërbisë, të ish-Jugosllavisë.

Aty ju ka dhonë goditja atyne, a na jena liru kena pasë fat. Na lirunë, na thirrën mas ni kohe apet në Prishtinë, shkalla e dytë edhe Bajram Kelmendi thotë, "Osht' rrezik apet me ju burgos". Tubohem na edhe merremi vesh me shku për Slloveni. Azizi e Burhani e krejt ata vijnë qitu {tregon përballë} e kom pasë shpinë e vjetër, këta të Mitrovicës Mensur Fejza me do, thojnë, "Po shkojmë" thashë, "Për nerë jo". Thashë, "Ishalla kurrë s'më marrin, po nesër ne të më marrin" thashë, "kurrë nuk dalë prej shpije. Më lutët" thashë, "hiç, u krye kjo punë" thashë, "nuk ka forcë që më bind me dalë prej shpije, le të më burgosin".

Edhe nuk shkova une, as Mensuri, tha, "Që nuk shkon Ibushi, as unë nuk vi". Mensuri ka qenë me moshë ma i vjetër se unë. U konë inzhinjer i mirë, i mirë u konë, unë jom konë do të thotë eprori i tij. Tha, "Që nuk vjen Ibushi...". Jonë shku ata krejt jonë shkue. Prej Kosove janë shku në Slloveni, kanë nejt sa kohë, veç unë edhe Mensuri s'jemi shku hiç. Po nuk ndodhi kurgjo mo ajo punë. Qe qishtë ka qenë ky detal.

Anita Susuri: Pastaj mas ni kohe edhe i kanë largu prej punës minatorët, masi keni dale ju prej burgu.

Ibush Jonuzi: Po.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu tani, kanë qenë do aktivitete si lloj ndihme "Familja ndihmon familje".

Ibush Jonuzi: Po, po.

Anita Susuri: Sindikata u formu...

Ibush Jonuzi: Ne na kanë lirue me 24 prill, të vitit '90 prej burgu, të nesërmen jemi shkue në punë, jemi shku në punë unë edhe Burhani, jemi marrë vesh me shkue. Ka qenë policia shumë e mobilizume. Pse? Urdhni ish konë. Mu më ka tregu policia, ka pasë policë tonët, më kanë tregu policia që, “Nuk bon me i leju me hy në zyre”. E kishin pasë caktue drejtor nifarë Beqir Mehmetin atëhere. Edhe shkumë në zyre, ai na priti mirë, “Mirë se keni ardhë, shqyqyr që u lirutë” krejt ato edhe prej këtij momenti tha, “une tërhiqna prej kësaj pozite” tha, “se ju jeni për këtu, juve ju dojnë minatorët, juve ju donë poplli edhe ju me konë këtu”.

Na i lëshun vendimet Këshilli i Punëtorëve se përfundojke procedura domethonë e mandatit. Edhe përsëri rizgjedhje për mu po flas për veti drejtor teknik, Këshilli i Punëtorëve e mur vendimin për rizgjedhje në mandatin e dytë. Shkumë disa herë, po s’kishe shancë. Edhe pastaj qysh veprojnë me 8 gusht [1990] i largojnë krejt minatorët. U largunë prej pune edhe kanë metë vetëm katër a pesë shiptarë. Ka metë ni inxhinjer, nifarë Bejtullah Kurti, si inxhinjer u konë kogja i mirë në profesion, po u konë pak dinak, u përzie edhe anenaj, a din qysh thojmë në dy anët.

Kur u ktheva 2014 në “Trepçe” ai erdh në zyre tha, “Qishtu, qishtu jom ardhë me më marrë në punë, ti më ngjeh” thashë, “Bejtë”, thashë, “jom metë pa pune” thashë, “Edhe na jena metë pa punë” thashë, “ti ke punue” thashë, “kërkush s’ta ka imponu ty që m’u nalë gjithqysh”. Thashë, “Ti ke punu këtu në Staritërg, ke punu në Kishnicë knej-anej” thashë, “po ti s’ke dashtë me ju bashkangjitë vendimit, qëndrimin të gjithë, edhe minatorëve edhe inxhinjerëve”. Thashë, “Ja-a, ti këtu s’munësh me punue, veç për qita” thashë, “s’munësh edhe u kry muhabeti”.

Edhe jonë nalë nja tre-katër punëtorë që unë i kom ngjoft, tetonë mirë i kom ngjoft, qysh thojnë në pikë të natës jom konë në shërbim tyne. Hajde naj minator, amo inxhinjeri m’u mashtru në atë sen nuk ka guxu, ai ka gabue. Ai osht’ edhe sot, po ka gabu shumë se nuk bon. Nëse e qet interesin personal para interesit të përgjithshëm kurqysh s’bon. Baba jem rahmet shpirti i pastë, ka dekë i ri, p’e citoj, thojke, “Bre bal kurrë mos lejo me të shkelë në dinar, si të shkelë në dinarë kurgjo s’ka prej teje”, qashtu. Interesin personal si te qet individi, s’ka aty kurgjo hiç.

Anita Susuri: E vitet e ‘90-ta qysh kanë shku tani, çka keni bo ju, çka keni punu? A keni qenë në kontakt me...

Ibush Jonuzi: Minatorë.

Anita Susuri: Po.

Ibush Jonuzi: Po, po kemi qenë në kontakt në vazhdimësi edhe kemi majtë edhe tubime, kemi majtë tubime nëpër xhamia, kemi majtë tubime edhe nëpër oda. Edhe filloi ai aksioni “Familja e mban familjen”. Kjo pjesa e Preshevë, Medvegjë, Bujanovc kanë bo shumë, na jemi shku njëherë veç me ju falenderue. Ata kanë dhonë të mira materiale, janë konë të caktume familjet, cila familje e manë

familjen e minatorit. Kjo pjesa e Malishevës, pjesë e Pejës, Deçani, Dukagjini krejt kanë qenë shumë mirë të organizuem për me i majtë familjet e minatorëve.

Po edhe meniherë filloi lëvizja e madhe e tyne për me dalë jashtë. Numri ma i madh i minatorëve të Stantërgut janë në Suedi. Pat shku ni delegacion i deputetëve të Parlamentit të Kosovës në Suedi edhe kur u kthyn po më thotë Fadil Geci që nashta e njifni po edhe... tha, “Bacë, ti ish dashtë m’u konë në Suedi” tha, “musafir” tha, “se ata krejt” tha, “ty po të njofshin”. Se jonë konë, pjesa ma e madhe jonë konë në Suedi. Edhe jonë majtë, jonë majtë tu ju falenderu solidaritetit të familjeve tona po edhe mërgata ka bo shumë, ka bo shumë edhe mërgata. Edhe kështu ka qenë atëherë me dalë.

Une personalisht as nuk jom dalë, as nuk kom qit fëmijë, qashtu jom konë i përcaktum, kom punu ça kom mujtë. Në atë kohë kena majt lopë edhe kena metë qashtu gjallë me qumësht, me qeto gjana elementare veç sa me mbiejt mos me ja shtre dorën. Shumë herë edhe gjatë viteve të ‘90-ta më kanë marrë në polici. Une kom qenë aktivist i LDK-së edhe kom qenë sa për “Trepçën” i përkushtum me punue. Pse? E kena pasë prijësinë jashtëzakonisht të mirë, legjendë u konë Ibrahim Rugova, ai u konë gjithçka. Edhe e ka pasë thonë në një moment, tha, “Ju lutem, gjithkujt ka m’i dalë fotografia kush çka osht”. E po e shohum, atina po i delë çdo ditë kush u konë Ibrahim Rugova.

Ni përvjetor të grevës së minatorëve i bomë do farë pamfletësh, do farë, edhe ju kanë ra në dorë shkiqeve. Jonë ardhë në shpi, jonë hi policia mrena mathun, nona u konë, edhe ajo e lodhun plakë. Edhe ni motër aty e martume, ka nja dy vjet ma e re se une, ka thonë, “Kadale qy nona plakë”. Tha, “Kur të m’u kanë vërsulë” me i ra, “Ku osht?” Tha, “U dalë” tha, “në qytet osht’. A osht’ në LDK, a s’di ku osht’”. Edhe jonë ardhë drejt në zyre të LDK-së më kanë gjetë. “Hajde ty po të lypëm” thashë, “Qe ku jom une”. Po thom 50, a 60, a njëqind e sa raste, as vet s’e di, më kanë marrë në polici. Kohë mas kohe kështu më marrshin.

Në protesta që u bojshin në vitet ‘98-‘99, une niherë u morëm vesh në një tubim të LDK-së kush me ju pri protestës, se gjithkunj ju e dini edhe në arë kur prashitshum u dashke ni njeri m’u konë i parë me thonë, “Po ulem qetash, po çohem qetash”. Diskutum krejt, thashë, “Une dalë i pari”. “Pse lbush?” Thashë, “Une e kom kapuçin e bardhë, une dal i pari”. Edhe qashtu ka qenë, ju kom pri minatorëve, kësi protestuesve. Kur u ardhë për me u nisë na kanë dale me kerr policia. Thojmë na te parku qaty, tha, “Ku po shkoni?” Thashë, “E dini ju ku”, tha, “Ku?” Thashë, “E dini ju ku” tha, “s’ka shancë” thashë, “E kqyrum sa të bohet ora, ora 11:00”.

Si u bo 11:00 une përpara kur masa krejt, a din atëherë u konë masë e madhe. Edhe kemi vazhdue, kemi shku para objektit të Gjykatës Komunale ku ka qenë, ka qenë podrumi e do kapakë të metaltë jonë konë përmi asaj. Edhe ku me ditë qysh i kanë shkelë edhe panikë ka pasë, e të bohet panikë aty, e kcej une hipi maje kerrit të policisë. Pasha Zotin as vet s’e di qysh jom hipë, veç... edhe ata m’i kanë fut automatat, une t’u menu që mu më kurtarisën qatëhere. Pshtova. U kthyem përfundoi protesta, apert tjetrën ditë qashtu.

Nifarë Hashim Parduzi ka qenë minator që i vetmi ka qenë në grevë atëherë, i Vushtrrisë u konë, pensionist i “Trepçës” e kanë marr e kishin pasë rreh, ja kanë bo trupin si qekjo {prekë pantollonat e

zeza}. I kanë thonë, “Ti po del me Ibushin në protesta”, këtu policia e Vushtrrisë. Ka thonë, “Po une ato e kom pasë shef une dal me ato”, “Kqyre edhe niherë që del krejt kemi me të pyt edhe mos gabo me i kallxue”. Si të del prej stacionit ai vjen në zyre të LDK-së drejt, thotë, “Drejt qishtu, qishtu, qishtu”. “Ça ju the bre Hashim?” Thashë, “Vallahin apet unë dal, si të del ai unë dal” (buzëqeshë).

E po thom qishtu situata atëherë u konë. Ju jeni të ri edhe shqyr që jeni të ri, jeni të mirë. Po, po thom u konë, u konë situatë shumë e ranë, po krejt ato na kanë pru qetu se përndrysh nuk kishim mujt me ardhë. Edhe UÇK-ja edhe faktori ndërkombëtar edhe Zoti, Rugova që na lidhi me amerikanët, se kërkush nuk ka besue që na mujna me u shku. Të gjitha intervenimet kirurgike janë të rona e ai në zemër osht’ ma i roni. Une jom shiptari i parë që jom shkue mas lufte në “Trepçe”, me 30 tetor të vitit ‘99. Shkijet jonë konë t’u punu aty, jonë ardhë dy ushtarakë të KFOR-it me dy automatika, ni djalë i ri përkthyes.

“Mirëdita”, “Mirëdita”, “A je Ibush Jonuzi?” Thashë, “Po”. “A ke punu në ‘Trepçe?’” Thashë, “Po”, “A je konë drejtor?” Thashë, “Po, jom konë”. E nxuri ni fotografi A5 temën edhe kështu po më kqyr {e shikon dorën e vet}. Tha, “A je i interesum me shku?” Thashë, “Shumë”. Tha, “Hajde” thashë, “Hajdeni ka ni kafe dej të pregaditna” thanë, “Jo, na të presum, pregaditu”. Edhe jom pregaditë, jom hi në atë Reno 4, ata dy ushtarakë me automatika edhe qai përkthysi. Jena shku detalisht gjithçka kom kqyrë.

Ata katër orë, jo si intervista e juve dy orë {shikon telefonin} a sa u bonën qitash, jo valla dy orë e gjysë boll zgati (qeshë). Katër orë unë me ta, “Çka munët me ndodhë kjo?” Ata krejt preokupim për minierë çka ndodhë. Une tu ju spjegu, “Kjo, kjo, kjo”. Ju thashë u konë restorani shumë modern, kur jena shku poshtë e ka pasë podrumin restorani, kom pa konopa të kafshëve të lidhun për radiatorëve e gjak aty. E tanaj e kom pa që osht dëmtu, po aty e kom përjetu shumë ronë.

E vërejtën ata ushtarakët edhe po më thotë njoni tha, “Ronë p’e përjeton?” thashë, “Shumë ronë”. Tha, “Po bohen”, “Do” thashë, “kurrë nuk bohen” thashë, “do s’ka shansë me u bo, s’kthehen mo ato”. Edhe më kthyen në shpi, mas tremdhetë dite une kom pësu infrakt, mas 48 orëve më kanë çu drejtë në spital pa vetëdije. Mas 48 ore mjeku më ka thirrë në zyre, ka thonë, “Ça u bo?” Ata më njihshin këta mjekët tonë, “Ça u bo bre Ibush? Ti je i qetë e sene”. Thom, “Qishtu, qishtu”, “Eh” tha, “qajo tek o pasojë”. Qajo domethonë ka pasë gjithçka kena përjetu në atë kohë.

Anita Susuri: Po qysh e kemi kuptu na edhe miniera u konë para kolapsit mas luftës. Ka qenë në gjendje shumë të keqe.

Ibush Jonuzi: Mas lufte na kena fillu kapak në minierë edhe une jom shkue m’u pregadit edhe aty do... se e kishin pasë shfrytëzue në mënyrë jo profesionale, në mënyrë të tmerrshme e kanë shfrytëzue. Veç çka kanë mujt me grabit, edhe ato mjete i kanë shkatërrue gjithçka. Po mjetet bohen, a miniera osht’ problem kur shfrytëzohet jo në mënyrë profesionale me stabilizu me pru në vend. Ka qenë ni amerikan administrator në Vushtri Charles Denison Lanen edhe vjen në mledhje të kryesisë së LDK-së. Ni profesor Hajzer Krasniqi i ndjerë, ka qenë kryetar i degës, une jom konë nëkryetar i degës.

Erdh në mledhje tha, “Zoti Krasniqi” tha, “jom ardhë me punë” tha, “Ani, Deni”. Ka qenë shumë i rreptë, tha, “Zoti Krasniqi, kom ardhë me punë, s’kom kohë me të pritë une ty. Ju LDK-ja duhet...” në atë qeverinë e përkohshme, “me e çue përfaqësuesin e juaj ose une raportoju që ju s’jeni të interesum për pushtet. Edhe aty” tha, “munet me ardhë veç Ibush Jonuzi prej LDK-së” tha, “edhe kërkush tjetër”. Edhe krejt metëm pa tekst, po besoni që më zuni krejt objekti. Po më thotë ai kryetari, “Ibush, mos u gut Ibush. Mos u gut se ky është amerikan na dëmton”.

Thashë, “Une nuk të vi”, “Pse” tha, “nuk vjen ti?” Thashë, “Unë e kom shpirtin për ‘Trepçe’ nuk vi, kurrë nuk vi aty”. Edhe çona dal unë në mënyrë demonstrative prej meldhjes vi në shpi, ni profesor i anglishtës Shaban Krasniqi u konë përkthyes i tinaj edhe i thotë, “Shko” thotë, “vete” thotë, “me shku na në shpi”. Edhe vinë ata në shpi, m’u kish kallë shpija, ni stufë e kom pasë të drunit të keqe mas luftës, s’kishum. Pesë orë, unë s’kisha ditë kurrë që kena nejt pesë orë t’u më lut. Po, u ardhë vëllau i ka thonë nonës, “Kush o oj nonë?” “Valla s’di bre loke qe pesë sahat janë mshelë qaty, s’di ça po bohet”.

Edhe vjen vëllau ma i ri se une, edhe ai ka punu në Staritërg, më fal ma i vjetër se une osht’ edhe p’i ndëgjon fjalët. Erdh qai administratori, erdh qai kryetari Hajzeri, ni çikë shumë e meritueshme, ka punue shumë edhe ai përkthysi, katër vetë t’u më lut. Tani ma shumë ky kryetari, “Ibush duhet gjithqysh me shku. Ky është amerikan, ky na don tonë”. Une kategorik, “Kurrë nuk vi”. Vjen vëllau thotë, “Ibush bre gjakun me pasë duhet me ja falë gjithë ketë lutje, a p’e sheh qysh po të lut?” Thashë, “O Hetë, kom obligim ndaj ‘Trepçës’” tha, “Ki obligim edhe ndaj Vushtrrisë” tha, “Dhetë vjet të ka ndëgju Vushtrria”.

Që realisht qashtu osht’, që krejt qytetarëve të Vushtrrisë jom shumë mirënjohës, shumë falenderues. Edhe ju thom, “Kom me ardhë” thotë, “Çu ama dorën se ti je shiptar”. Tha, “Veç të raportoju une se Ibush Jonuzi u hi në komunë” tha, “ta dho kerrin e UNMIK-ut, vozitësin e UNMIK-ut, ti shko në ‘Trepçe’ kur dush. Kush ty s’të vet, veç unë du me ditë që ti je hi në Komunë të Vushtrrisë”. Fillova, po une e kom nifare principi nuk muj, që thojnë në dy anë nuk muj. Kur ja nisi ni pune kom qef veç qasajna m’i grah.

Pak ditë edhe e lashë “Trepçën”, i prunë do mjete atëherë me i nda për minatorët, që ke fjala jo veç të mira materiale po edhe mjete kanë pru. Edhe në pliko m’i kishin pasë nda edhe mue. Thashë, “Ja s’i marrë kurrë” thashë, “ja-a”. Azizi i ndjerë, thashë, “Ka kush i merr, jepjani kujt doni une kurrë s’i marr” thashë, “ja-a, s’i marr une këto. Une kom mundësi” thashë, “me u gjetë e nuk i marrë” edhe s’i kom marrë. Tani kom punu në komunë në atë qeverinë e përkohshme në 2000-tën dej jonë majtë zgjedhjet.

Po kthena te spitali, nejta ni mujë në spital mjekët tonë thanë, “Ibush na s’kena mundësi kurgjo me të bo veç në mujsh me dalë jashtë”. KFOR-i Emiratet e Bashkuara Arabe kanë qenë të stacionuar në Vushtrri. Ish konë ardhë ni kirurg mjek domethonë këtu edhe më thotë qai amerikan, më thotë, “Ibush ka ardhë ni kirurg i mirë a shkojmë?” Thashë, “Shkojmë, Deni”. Edhe shkumë bashkë me to, p’i thotë, “Ibushi o qishtu e qishtu e...” edhe qashtu ja thojke, a din? Edhe ai tha, “A ki dokumenta” thashë, “Çka po mendon?” Tha, “Pasosh” thashë, “Unë as letërnjoftim s’kom”. S’kisha as letërnjoftim se ma kishin marrë shkijet letërnjoftimin.

“A kije të spitalit?” Thashë, “Po, kom të spitalit”, “Hajt, shko bimi!” Erdha në shpi, i mora, ja çova. Tha, “Pregaditu kena me të çue”. E më kanë çu në Abu Dabi, me aeroplan të KFOR-it mu më kanë çue. Para zgjedhjeve të vitit 2000 unë s’kom qenë këtu. Jom shku pesë ditë para zgjedhjeve bile pata lut, “A ka mundësi me votu?” Thanë, “Jo, s’ka mundësi”. Ka qenë ni detal interesant, u konë ni amerikan edhe ni zviceran që jonë konë në komunë. Veç kogja shumë më kanë dashtë edhe më kanë besue. Tha, “Ibush kije me shkue, kije me bo mirë”. Se menxi u ngjitsha shkallëve të komunës, pata pasë, infraktin shumë të ronë e kom pasë.

Edhe tha, “Masi s’je në zgjedhje me na shkru sa kini me fitu ju LDK-ja, shtinë në një pliko edhe lema”. Edhe e marrë une e shkruaj 64 përqind, ja dho plikon e mbyllne, pos Zoti edhe unë kush s’e ka ditë. Edhe shkoj une atje, e boj ni intervenim m’i vendosin dy stenda, ni balonë. Bilë më tha, ish konë mjek nifare Naseri, ai e kish pasë kry fakutetin në atë kohë në Sarajevë edhe vike qitu u ulke në krevet bisedojke me mue. U majtën zgjedhjet e para lokale LDK-ja në Vushtrri fitoj 64 përqind. Më thirri ai amerikani në telefon, “Dy herë” tha, “ke fitue” tha, “edhe ke fitu si LDK edhe ke fitu që e ke qit” tha, “qind për qind shifrën 64 përqind. Qysh e dite?” “Po qysh s’e dita Deni? Une dhetë vjet me ta” thashë, “unë e di qysh marrin frymë këta njerëz”.

Pata nejt atje në spital edhe tani u dashke me u bo konstituimi i asamblesë e krejt, tani presion, “Hajde, hajde” i thom mjekut, “Qishtu po më thërrasin”, tha, “Të tregoj unë mas tri dite”. Tha, “Kena vendosë me të lejue, t’i jepum barnat për ni vit, mjekun ta dhomë me veti deri në Kosovë ka me të përcjellë”. U ktheva, u zgjedha nënkryetar i komunës, edhe kryetar qai profesori, po u konë shumë i smutë, u konë fortë burrë i mirë. U konë shumë i përgaditun, shumë i sinqertë, shumë shiptar ka qenë, po i smutë. Edhe nuk mujke me ardhë, rrallë vike, une e udhëheqësja komunën.

Në zgjedhejt nacionale, ai amerikani më pyeti tha, “A të propozon partia për deputet?” Thashë, “Nuk e di Deni. Pse?” Tha, “Që të propozon, shko!” Tha, “Nuk je ti me punu me hajna në Vushtrri”. Krejt po thom origjinal qysh më ka thonë. Mu më ka çu në sallë të Kuvendit të Kosovës pa konë deputet, pa konë... “Veç ki me shku me kqyr” thojke, “ti”. Tani më propozun për deputet fitova në zgjedhje 2001, fitova në zgjedhjet 2004. Kom qenë në vitin ‘92 deputet, kom qenë në vitin ‘98 deputet. Kom qenë anëtar i Bordit të Minierave në vitin ‘97, 2007-2009. Kom qenë anëtar i Bordit të Minierave në vitin 2014, me shumë kërkesa m’u kanë lut me u kthye në “Trepçe”.

Jom kthy 2014, 2015 ju kom thonë, “Kom me dalë në pension” më kanë thonë, “ti ki me dalë në pension, ti ki me punu sa të dush në ‘Trepçe’. Kush ty s’të ngucë se na vyen”. Kom punu edhe 16 mujë në pension, domethonë mas pensionit në “Trepçe” edhe e kom marrë çantën mas 16 mujve. Më kanë lut me shku me konkuru për bord, kom thonë, “Kurrë! E kom mbyll une”. Më tha njeni, “Me hi në histori”. Thashë, “Ja më fal unë në histori për ‘Trepçe’ jom hi” “Jo qashtu osht’ veç...” “Jo veç po të tregoj” thashë, “masi më the me hi në histori” thashë, “une jom hi në histori” edhe qekjo ka qenë karriera jeme.

Anita Susuri: Veç deshta me ju pyet edhe për përjetimin e luftës, a jeni konë këtu apo qysh ka qenë me juve situata?

Ibush Jonuzi: Po nuk kom qenë ushtar aktiv, po kom qenë shumë aktiv. Drenicë, Shalë, s'ka vend që s'e kom shkelë. Ditën kur, kur i kanë sulmu Jasharajt, me të 5, 6 [mars], une me të ndjerin Shefki Pupovën që ka qenë gazetar, me Bajram Mulakun që u konë kryetar i komunës e dini nashta, e keni përcjellë, tri mandate, edhe i ndjeri Hilmi Gërguri jemi shkue në Galicë. Kur jemi shkue në Galicë plot qytetarë ishin konë aty nëpër fshat. Bajrami tha, "Ibush une ma anej nuk muj me ardhë" thashë, "S'munësh rri, s'ka aty me ja imponu kërkuj".

Une, Hilmi Gërguri, Shefki Pupovci, që dytë jonë të vdekun, jemi hi dej në Prekaz. Na kanë diktue edhe nifarë Haxhije i Prekazit ish konë, emrin Haxhi e kish pasë e pata pyt, "Qysh e ki emrin?" Tha, "Haxhi e kom". Jena hi ni pleme edhe e kanë granatu plemën, po kur ka njeri ymër jena shpetue. Kur i kanë masakru Jasharajt, une jom shku i kom kqyr edhe ata. Me qat' çikën që e përmena, qat Bahrije Spancën. Krejt jonë konë të ekspozum me një depo të materialit ndërtimor, te tonë e kom pa, te tonë njo ka njo. Atje koftë, Ademi ka qenë në fyt i premë. Kom qenë shumë aktiv.

Kur e kanë sulmue Likoshanin, familjen Ahmeti, na Vushtrria kemi qenë njerëzit e parë që kemi hi aty edhe me ndihma edhe me të gjitha. Motrën e tyne Sadijen që ka shpëtue e kemi marrë me kerr prej Likoshanit, e kemi çu në aeroport për Zvicër. Në vazhdimësi kom qenë në bashkëpunim me ta kur e kanë marrë drejtorin e burgut të Mitrovicës, Sherafedin Ajetin, familja e tij më ka thirrë në zyre të LDK-së me telefon, "Ti e ki mirë me UÇK-në qishtë e kanë marrë me e pshtue". Thashë, "Ja-a, unë në ato pune nuk përzina", "Jo, munësh", "Ja, ja" thashë, "më fal nuk përzina unë në ato punë". Edhe s'kom dashtë m'u përzie.

Anita Susuri: Ai ka qenë në zo të keq.

Ibush Jonuzi: A?

Anita Susuri: Drejtori i burgut ka qenë i keq.

Ibush Jonuzi: Po. Domethonë, ata e kanë, e kanë kurtalis dikun (qeshë). Deri me 19 prill të '99-tës, qitu jonë ardhë {tregon djathtas me kokë} policia me autoblanda edhe qysh jena konë krejtve na kanë dhonë pesë minuta afat. Jemi hi në kolonë edhe tri ditë e tri netë kemi bo dej jemi dalë në Shipri. Përnrysh, kom mirënjohje prej UÇK-së, prej Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me shkrim kam mirënjohje që ma kanë da për kontributin dhe angazhimin tim që ka qenë. Thashë, nuk jom konë me pushkë.

Kom shku në Polac, i ndjeri Ilaz Kodra, ka qenë ni ushtarak i mirë, e kanë vra. Tha, "S'ka mo qeveri, s'ka kjo" thashë, "Jo, jo të lutna ka edhe ka edhe ka me pasë". Thashë, "Une nuk jom përcaktu për pushkë", thashë, "une jom përcaktu me ta pru ty bukën" thashë, "Mos mufsha 50 kilogram, 25 kilogram kom me ti pru prej Vushtrisë" thashë, "ti pushkën, une bukën" tha, "Qashtë oshtë bac!" Edhe bukë edhe barna edhe të mira materiale edhe dru edhe gjenerator edhe guma të kerreve edhe telefona edhe krejt. Po thom, krejt i kena bo na për ta. Edhe ju thojshin në shtab, kur shkojshim me grupe kështu që për të mira materiale thojshin, "Hiç s'kini nevojë me ardhë, me na thirrë neve. Veç thuni çka të thotë Ibushi" thojke, "na i kryjna".

Na qitën në Shipri, na u nalëm në Durrës te rrethrotullimi, te Plepat nashta e dini. Bomë tri ditë e tri netë, shi çoi Zoti ato ditë se ka qenë kolona ma e madhe atëherë kur jemi dalë. Edhe po thotë tha, “Duhet me shku për Fier” thashë, “Çfarë Fieri” thashë, “na krejt jena dekë”. I thom atij vozitësi... se me do kamiona na murrën, kur hinëm në kufi, thashë, “Jo çfarë”. Tha, “Veç me shku në bashki të Durrësit” thashë, “Jo, shkojmë”. E çona une shkoj aty, bisedoj me to i thom, “Po të qarrosi”. Edhe nashta s’o për kamerë kjo veç qishtu ka qenë origjinal. Edhe ja dho niqin marka une, e të organizohen të na bijnë ni kamp në Shijak ka qenë, kampi “Arcobalena” italian. Qaq mirë na kanë trajtu aty, qaq mirë ka qenë.

Na e patëm organizu aty edhe mësimin edhe çdo gjo ka qenë në nivelin ma të lartë. Momentin e përfundimit të marrëveshjes së Kumanovës u konë ni femër përgjegjëse e kampit, italiane, e mu më pat zgjedh kryetar të kampit aty. Edhe ju thojsha... jonë konë 947 banorë aty. Thojsha, “Jo bre...” “Ja, ja veç ti kije me konë”. Erdh ajo italianja më tregoi, se ni tendë e kishim kështu ku e majshim komunikimin e koordinimin me qytetarë. Tha, “Kryetar”, tha, “osht’ nënshkru marrëveshja e Kumanovës, veç ti duhet me i lutë qytetarët mos m’u gut se osht’ rrezik me u kthy, osht’ kështu, osht’ kështu”, tha, “nesra ti i thërret qytetarët edhe i njofton”. Veprua qashtu.

Edhe e kena pasë kështu ni tendë të madhe me megafon edhe të KFOR-it aty, ajo përgjegjësjë. Thashë po me m’vet, “A kije m’u kthy ti?” Thashë, “Une ju thom po”, po ju thom atyne paraprakisht. U çu ni plak i Rahovecit u konë me kapuç të bardhë, tha, “Kryetar ni pytje” thashë, “Urdhno”, “A kije m’u kthy ti?” Thashë, “Po vallahi, meniherë”. Ata, “Qysh e dite?” Thashë, “Po qysh s’e di ça vesin këta njerëz?” Thashë, “Unë e di”. Edhe une jom kthy me dy djem të vllaznive, meniherë jom kthye. Jom kthy në Kosovë, familja u metë atje edhe nja dhetë ditë, tani jonë kthye krejt.

Në kamp edhe niherë po kthena kena bo model të ni organizimi të shkëlqyeshëm. Osht’ ardhë ministri jo veç i Shiprisë po edhe i Italisë ministri i arsimit osht’ ardhë, na ka vizitue me pa qysh na e kena organizu mësimin aty. Edhe të reja qishtu sikur ju çika e nuse i qitsha në mëngjes me dorëza {prekë duart} edhe jashtë kampit me pastrue sikur këtu me e bo. Domethonë, ka pasë tona komunave, ka qenë organizimi fort i mirë. Edhe tani qysh e dini u kthyn tetonë edhe Toni Bleri mirë e pat thonë, “Kosova e ka meritue me pasë pavarësinë e vet, me u përkrah sepse përmeniherë u kthyen”. Qajo ka qenë dëshmi shumë e madhe.

Korab Krasniqi: Veç deshta me pyt kur je kthy mandej prej Shipnisë, qysh i keni gjet pronat?

Anita Susuri: A jonë djeg...?

Korab Krasniqi: A jonë djeg, a i keni pasë... a s’i kanë prekë a?

Ibush Jonuzi: Po, jo shpija jeme u konë e digjët, u konë e digjët. Që thashë me lonë, i kom pasë tri lopë të mira, te trijat i kanë marrë, kurgjo s’u metë këtu. I kena pasë do rezerva, po ato i kanë marrë njerëzit tonë, me hallall, edhe të millit edhe të ushqimit e krejt ato. Une jom konë koleksionar i lapsave, kom pasë marak lapsa me pasë, edhe kom lapsa që më kanë pshtue do, se m’u kishin dëmtu krejt, i kanë gjue. I kom pasë do kristala të bukra, ato jonë konë vet qaty, ato krejt të mirat i kishin pasë marrë. Edhe qishtu domethonë krejt ça ka pasë u konë e dëmtume.

Qysh fillun me dhonë ndihma unë isha vet në komunë, e po më thotë nona ni ditë, “Bre loke” tha, “tonë po marrin e për neve diçka?” Thashë, “Nuk bon nonë”. “Pse?” Thashë, “Jo, na kena mundësi me bo” thashë, “Le të marrin ata që s’kanë”, “Eh, ani pra” (qesh). E kom pasë nonën jashtëzakonisht të kuptushme, me ni fjalë me to u marrshe vesh. Edhe qishtu ka qenë dalë ngadalë nisëm me i marrë hapat, me punue, me gjallnue, me krejt ato.

Anita Susuri: Nëse doni edhe diçka për fund me shtu, a me tregu urdhnoni?

Ibush Jonuzi: Për fund, ju falemnderit juve! Nëpërmes këtij emisioni nëse del najherë, të gjithë ata që i përmena në veçanti minatorët i përshëndes, ju dëshiroj shëndet, jetë të lumtur. Dëshiroj që kjo minierë e shkëlqyeshme me e marrë veten. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet me e përkrah. Duhet me përkrah se ky osht’ interes jo veç i minatorëve, po osht’ interes nacional osht’. Osht’ fat i madh që miniera rezervat i ka. Une jom shumë në rrjedha edhe për pasuritë që i ka, hulumtimet kah jonë bo. Që m’u aktivizu, jo na me shku me punu në Zvicër e Gjermani, po me kriju kushte, me kriju rrethana, që njerëzit tonë këtu me punue.

Osht’ ni xehe që veç në pesë vende në botë ka alloizit, që osht’ në minierën e Artanës. Gjermanët kanë qenë të interesum që me bo agjensionin kosovaro-gjerman, të përbashkët. Na kanë thirrë në 2014-tën me menaxherin e “Trepçës” ni profesor Ahmet Tmava dhe unë me shkue. Na i kanë dhonë vizat për tri vjet meniherë. Edhe me bo na qat’ agjension të përbashkët, na me shfrytëzue xehen, këtu me u punue, këtu me u bo prodhimi final, ai prodhim përdoret në mjekësi. Po, me keqardhje duhet me thonë po osht’ realitet, meniherë politika te na me hap... çka...

Xhavit Haliti thojke, “Gjithkush i ka ka dy-tre milion”. Jo dy-tre milion s’i ka, mu më ka ra lëkura copë qysh thojnë, edhe sot i qes dorëzat e punoj fizikisht, a i kom 71 vjet. E ai dy-tre milion po i bon pa njersë {prekë ballin}. Edhe e panë gjermanët u tërhiqën edhe prej asaj edhe prej agjensionit, prej të gjithëve. Krejt osht’ shkak i menaxhimit jo efikas të institucioneve shtetërore tonat, se ajo ka pasë me shkëlqye, interesi reciprok ka qenë edhe i gjermanëve edhe i joni, po ata e diktun, ata e nuhatën ma shpejtë se na edhe hiqën dorë.

Anita Susuri: Falemnderit edhe juve për kontributine dhe për tregimin e ju!